

# SONY®

## Sistem audio në shtëpi

**Udhëzimet e përdorimit**

---

Fillimi

---

Funksionimet

---

Lidhjet me rrjetin

---

Informacioni shtesë

---

Zgjidhja e problemeve

---

Masat paraprake/  
Specifikimet

## PARALAJMËRIM

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj. Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, futeni njësinë në priza elektrike që mund të arrihen lehtë. Nëse vini re ndonjë anomali në njësi, shkëputni menjëherë spinën kryesore nga priza e rrymës alternative.

Mos e instaloni pajisjen në hapësira të kufizuara si p.sh. në raftë librash apo në mobilie në mur.

Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është futur në prizë, edhe nëse vetë njësia është e fikur.

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve të përcaktuara në Direktivën EMC për përdorimin e një kabloje lidhëse më të shkurtër se 3 metra.

## KUJDES

Përdorimi i mjeteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve.



Kjo pajisje klasifikohet si produkt LAZER I KLASIT 1. Kjo shenjë ndodhet në anën e pasme nga jashtë.

### Për klientët në Australi

Kjo pajisje duhet të instalohet dhe të përdoret me të paktën 20 cm dhe më shumë largësi mes radiatorit dhe trupit të personit (duke përjashtuar gjymtyrët: duart dhe kyçet e tyre, këmbët dhe kyçet e tyre).

### Për klientët në Evropë

Kabllo dhe bashkuesit e mbrojtur dhe të tokëzuar si duhet, duhet të përdoren për lidhjen e kompjuterëve pritës dhe/ose pajisjeve periferike.

Trysnia e tepruar e zërit nga kufjet dhe minikufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.

### **Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.**

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojuuni adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.

Përmes kësaj, Sony Corp., deklaron se kjo pajisje është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC. Për detaje, vizitoni URL-në e mëposhtme: <http://www.compliance.sony.de/>





**Hedhja  
e pajisjeve të  
vjetra elektrike  
dhe elektronike  
(e aplikueshme  
në Bashkimin**

**Evropian dhe shtetet e tjera  
evropiane me sistem të  
diferencuar grumbullimi)**

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

**Vetëm për Evropën**



**Hedhja  
e baterive  
të përdorura  
(e aplikueshme  
në Bashkimin**

**Evropian dhe vendet  
e tjera evropiane me  
sisteme grumbullimi  
të diferencuar)**

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që jepet me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.

Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkomporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi.

Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.

Për të dhëna më të hollësishme mbi riciklimin e këtij produkti ose të baterisë, kontaktoni me bashkinë, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

# Përpara përdorimit të këtij sistemi

Keqfunksionimet që ndodhin gjatë përdorimit normal të sistemit do të riparohen nga Sony në përputhje me kushtet e përcaktuara në garancinë e kufizuar për këtë sistem. Megjithatë, Sony nuk do të jetë përgjegjës për asnjë pasojë që lind nga dështimi i luajtjes ose keqfunksionimi i sistemit.

## **Disqet muzikore të koduara me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit**

Ky produkt është krijuar për të luajtur disqe që ndjekin standardin e kompakt diskut (CD). Kohët e fundit, disa kompani regjistrimesh tregtojnë disqe të ndryshme muzikore të koduara me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Ju lutemi vini re se mes këtyre disqeve ka të tilla që nuk janë konform me standardin CD, dhe mund të mos luhen dot nga ky produkt.

## **Shënim për DualDisc-et**

Një DualDisc është një produkt disk me dy anë i cili përmban material të regjistruar DVD në njërin anë dhe material dixhital audio në anën tjetër. Megjithatë, duke qenë se ana me material audio nuk është konform me standardin e kompakt-diskut (CD), nuk garantohet riprodhimi në këtë produkt.

# Pasqyra e lëndës

Përpara përdorimit të këtij sistemi .....	4
Veçoritë e këtij sistemi .....	8
Shijimi i muzikës nga burime të ndryshme .....	8
Shijimi i muzikës përmes rrjeteve.....	8

---

## Fillimi

Vendndodhja e funksioni i kontrolleve.....	9
Njësia (përpara) .....	9
Telekomanda .....	10
Lidhjet .....	13
Lidhja e antenave, altoparlantëve dhe kordonit të rrymës .....	13
Lidhja e pajisjes iPod/iPhone/iPad ose USB .....	14
Përgatitja e një antene LAN me valë .....	15
Vendosja e gominave të altoparlantëve .....	16
Futja e baterive .....	17
Vendosja e orës .....	18

---

## Funksionimet

Luajtja e një disku CD-DA/MP3.....	19
Krijimi i programit personal (Luajtja e programit).....	22
Luajtja e një iPod/iPhone/iPad .....	24
Modelet e përputhshme iPod/iPhone/iPad .....	24
Karikimi i një iPod/iPhone/iPad .....	25
Luajtja e një skedari në një pajisje USB .....	26
Karikimi i një pajisjeje USB.....	28
Përgatitja për lidhje BLUETOOTH.....	29
Çiftimi i sistemit me një pajisje BLUETOOTH .....	30
Lidhja me veprimin me një prekje (NFC).....	32
Dëgjimi i muzikës nëpërmjet një lidhjeje BLUETOOTH .....	34

---

## Lidhjet me rrjetin

Si të lidhni rrjetin .....	36
Konfigurimi për një rrjet me valë.....	37
Opsioni 1: Metoda për përdorimin e një aplikacioni për telefona smartphone ose tableta (pajisje Android/iPhone/iPod touch/iPad) .....	37
Opsioni 2: Konfigurimi manual duke përdorur Access Point Scan (Skanimin e pikës së aksesit) (për PC/Mac) .....	38
Opsioni 3: Metoda për përdorimin e një butoni WPS në pikën e aksesit që mbështet WPS .....	40
Konfigurimi i rrjeteve me kablo.....	41
Opsioni 4: Metoda DHCP .....	41
Dëgjimi i materialeve audio duke përdorur DLNA (Digital Living Network Alliance) .....	42
Dëgjimi i materialeve audio në kompjuter me Windows 8 .....	43
Dëgjimi i materialeve audio në kompjuter me Windows 7.....	46
Dëgjimi i materialeve audio në kompjuter me Windows Vista/Windows XP .....	49
Përdorimi i transmetimit muzikor në internet (Music Services).....	51
Përgatitja e pajisjes celulare si komandues .....	51
Shijimi i transmetimit muzikor në internet.....	52
Përdorimi i AirPlay.....	54
Përdorimi i aplikacionit “WALKMAN” në një Xperia/Xperia Tablet.....	56

---

## Informacioni shtesë

Dëgjimi i radios .....	57
Sintonizimi te një stacion radioje .....	57
Paravendosja e stacioneve të radios .....	58
Ekzekutimi i skanimit automatik DAB në mënyrë manuale (vetëm CMT-SBT300WB) .....	58
Përdorimi i komponentëve opsionalë audio .....	60
Vendosja e funksionit të gatishmërisë automatike .....	61
Vendosja e modalitetin BLUETOOTH/gatishmërisë automatike .....	62
Përditësimi i softuerit.....	63
Rregullimi i tingullit .....	64
Ndryshimi i afishimit .....	65
Përdorimi i kohëmatësve .....	66
Caktimi i kohëmatësit të fjetjes .....	66
Vendosja e Play Timer (Kohëmatësit të luajtjes).....	66

---

## Zgjidhja e problemeve

Zgjidhja e problemeve.....	69
Mesazhet .....	75


---

## Masat paraprake/Specifikimet

Masat paraprake.....	77
Teknologjia BLUETOOTH me valë .....	79
Specifikimet .....	81


# Veçoritë e këtij sistemi

## Shijimi i muzikës nga burime të ndryshme



\* AM disponohet vetëm për CMT-SBT300W ose DAB është vetëm për CMT-SBT300WB.

## Shijimi i muzikës përmes rrjeteve



### Këshillë

Ky sistem është i pajisur me funksionin DSEE për të riprodhuar një zë soprano të qartë pavarësisht uljes së cilësisë të shkaktuar nga ngjeshja.


Ai riprodhon tingull nga burime me ngjeshje të lartë si p.sh. MP3, me tingull natyror dhe të fuqishëm të ngjashëm me origjinalin.

Funksioni DSEE aktivizohet automatikisht duke njohur formatin e burimit të zërit.



# Vendndodhja e funksioni i kontrolleve


## Njësia (përpara)



### Shënim mbi funksionin e gatishmërisë automatike

Ky sistem kalon automatikisht në modalitetin e gatishmërisë pas 15 minutash nëse nuk përdoret ose nuk ka dalje sinjali audio. Si parazgjedhje, funksioni i gatishmërisë automatike është i aktivizuar. Për të çaktivizuar funksionin, shikoni faqe 61.

# Telekomanda



Ky manual shpjegon kryesisht veprimet me telekomandën, por të njëjtat veprime mund të kryhen duke përdorur butonat në njësi që kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm.

## 1 Butoni I/⏻ (energjia)

Përdoreni për të ndezur ose fikur energjinë.

## 2 Treguesi STANDBY

Ndizet kur energjia fiket. Treguesi pulson kur njësi dikton një anomali. Shihni "Nëse treguesi STANDBY [2] pulson" (faqe 69).

## 3 Sensori i telekomandës

## 4 Butoni(at) FUNCTION

### Njësia: Butoni FUNCTION

Sa herë që shtypni butonin, funksioni kalon në CD, USB, BLUETOOTH, DAB\*, TUNER FM, TUNER AM\* dhe AUDIO IN.

\* AM disponohet vetëm për CMT-SBT300W ose DAB është vetëm për CMT-SBT300WB.

**Telekomanda: Butonat CD, USB, BLUETOOTH, TUNER dhe AUDIO IN FUNCTION**

Shtypni butonin e funksionit korrespondues që dëshironi të aktivizoni.

## 5 Treguesi/butoni BLUETOOTH

Përdoreni për t'u lidhur/shkëputur me/ nga një pajisje BLUETOOTH ose për të kryer veprimin e çiftimit (faqe 31, 31, 35). Llamba qendrore tregon statusin e lidhjes së BLUETOOTH. Për hollësi, shihni "Rreth treguesit BLUETOOTH" (faqe 29).

## 6 Butoni ►|| (luaj/pauzë)

Përdoreni për të nisur ose vendosur në pauzë riprodhimin e një CD-DA ose disku MP3, ose një skedar në pajisje në lidhur iPod/iPhone/iPad, USB ose BLUETOOTH.

## 7 Butoni ■ (ndal)

Përdoreni për të ndaluar riprodhimin e një CD-DA ose disku MP3, ose një skedar në pajisje në lidhur iPod/iPhone/iPad, USB ose BLUETOOTH.

## 8 Butonat e paravendosjes së radios/ përdorimit të muzikës

### Njësia: Butonat TUNE +/- dhe ◀◀/▶▶











- Butonat TUNE +/-  
Përdoreni për t'u sintonizuar në një stacion të dëshiruar radioje ose për të paravendosur numrin e stacionit të regjistruar të radios.
- Butonat ◀◀/▶▶  
Përdoreni për të orientuar fillimin e pjesës ose skedarit. Duke mbajtur shtypur butonin, ju mund të përshpejtoni përpara ose prapa pjesën ose skedarin.

### Telekomanda: Butonat TUNE +/-, ◀◀/▶▶ dhe ◀◀/▶▶

- Butonat TUNE +/-  
Përdoreni për t'u sintonizuar në një stacion të dëshiruar radioje ose për të paravendosur numrin e stacionit të sintonizuar të radios.
- Butonat ◀◀/▶▶  
Përdoreni për të orientuar fillimin e pjesës ose skedarit.
- Butonat ◀◀/▶▶  
Përdoreni për të përshpejtuar para ose prapa një pjesë ose skedar.

## 9 Shenja N

Vendosni një telefon smartphone të pajisur me funksionin NFC pranë kësaj shenje për të kryer regjistrimin lidhjen apo shkëputjen e BLUETOOTH me një prekje. Për këtë veprim, kërkohet paraprakisht një konfigurim (faqe 32).


- 10 Dritarja në ekran**  
Afishon informacionin e konfigurimit të njësisë.
- 11 Foleja**  (kufje)  
Përdoreni për të lidhur kufjet.
- 12 Sirtari i diskut**  
Përdoreni për të ngarkuar një CD-DA ose disk MP3 (faqe 19).
- 13 Treguesi i efekteve**  
Informon statusin e përdorimit të këtij sistemi.
- 14 Butoni EQ**  
Përdoreni për të zgjedhur basin apo sopranon për rregullimin e tingullit (faqe 64).
- 15 Butoni**  (hap/mbyll)  
Përdoreni për të hapur/mbyllur sirtarin e diskut (faqe 19).
- 16 Butoni BASS BOOST**  
Përdoreni për të ndezur ose fikur përforcuesin e basit (faqe 64).
- 17 Butoni/çelësi i volumnit**  
**Njësia: Çelësi VOLUME**  
Përdoreni për të rregulluar volumnin duke e rrotulluar majtas ose djathtas.  
**Telekomanda: Butoni VOLUME +/-**  
Përdoreni për të rregulluar volumnin duke shtypur butonin + ose -.
- 18 Porta USB**  
Përdoreni për të lidhur një iPod/iPhone/iPad.  
Për hollësi, shihni “Lidhja e pajisjes iPod/iPhone/iPad ose USB” (faqe 14).
- 19 Butoni TIMER MENU**  
Përdoreni për të vendosur orën ose Kohëmatësin e luajtjes (faqe 18, 67).
- 20 Butoni SLEEP**  
Përdoreni për të vendosur kohëmatësin e fjetjes (faqe 66).
- 21 Butoni TUNING MODE**  
Përdoreni për të zgjedhur modalitetin e sintonizimit. Sa herë që shtypni këtë buton, modaliteti ndryshon në AUTO, PRESET ose MANUAL (faqe 57).
- 22 Butoni FM MODE**  
Përdoreni për të zgjedhur marrjen FM stereo ose mono (faqe 58).
- 23 Butoni TUNER MEMORY**  
Për të paravendosur stacionet e radios (faqe 58).
- 24 Butonat e përdorimit**
- Butonat      
Përdoreni për të përzgjedhur një artikull ose për të ndryshuar cilësimin.
  - Butonat  +/-  
Përdoreni për të zgjedhur një dosje (album) në një disk MP3 ose pajisje USB.
- 25 Butoni RETURN**  
Përdoreni për t'u kthyer në statusin e mëparshëm.
- 26 Butoni REPEAT**  
Përdoreni për zgjedhjen e luajtjes me përsëritje (faqe 20, 27).
- 27 Butoni PLAY MODE**  
Përdoreni për të zgjedhur modalitetin e luajtjes (faqe 20, 22, 23, 27).
- 28 Butoni DISPLAY**  
Përdoreni për të ndryshuar informacionin në dritaren e afishimit **10** (faqe 18, 35, 65).
- 29 Butonat BASS +/-**  
Përdoreni për të kontrolluar tingullin e basit (faqe 64).
- 30 Butonat TREBLE +/-**  
Përdoreni për të kontrolluar tingullin e sopranos (faqe 64).
- 31 Butoni CLEAR**  
Përdoreni për të fshirë një pjesë ose dosje të programuar (faqe 23).
- 32**  (treguesi i efekteve)  
Përdoreni për të ndezur/fikur treguesin e efekteve **13**.
- 33 Butoni**  (hyrje)  
Përdoreni për të futur një artikull të përzgjedhur ose cilësim.
- 34 Butoni OPTIONS**  
Përdoreni për të shfaqur një meny opsionesh. Shtypni  **24** për të zgjedhur menyën e radhës të opsioneve.  
**DEL LINK:** Për të fshirë informacionin e çiftimit BLUETOOTH (faqe 31).  
**BT/NW STBY:** Për të vendosur modalitetin e BLUETOOTH/gatishmërisë automatike (faqe 62).  
**AUTO STBY:** Për vendosjen e modalitetit të gatishmërisë automatike (faqe 61).  
**BT AAC:** Për marrjen e të dhënave në formatin e kodekut AAC nga një pajisje BLUETOOTH (faqe 30).  
**WPS:** Për lidhjen me një rrjet duke përdorur një pajisje rrjeti të përputhshme me WPS (faqe 40).

**NW RESET:** Për nisjen e lidhjes me rrjetin (faqe 38, 55).

**UPDATE:** Për përditësimin e softuerit (faqe 63).

Menytë e disponueshme mund të ndryshojnë në varësi të funksionit në përdorim.

## Lidhja e antenave, altoparantëve dhe kordonit të rrymës



### **A** Hyrja e energjisë (AC IN)

Pasi të lidhni të gjitha pajisjet, lidhni kordonin elektrik **E** me prizën në mur.

### **B** Bashkuesit e altoparantëve (majtas/djathtas)

Lidhni fort kordonin e altoparantit të djathtë **D** me R dhe kordonin e altoparantit të majtë **E** me L.

### **C** Foleja AUDIO IN (hyrja e jashtme)

Lidhni pajisjen e jashtme opsionale me një kablo të lidhjes audio (nuk është e përfshirë).

### **D** Bashkuesi LAN

Lidhni një kablo rrjeti (nuk jepet).

## **E** Antenat

- Ⓐ Antena përcjellëse FM (e përfshirë)  
(vetëm CMT-SBT300W)
- Ⓑ Antena qarkore AM (e përfshirë)  
(vetëm CMT-SBT300W)
- Ⓒ DAB/Antena përcjellëse FM (e përfshirë)  
(vetëm CMT-SBT300WB)


Për të marrë transmetime radio, lidhni antenat.

Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhe më pas vendosni antenat në një sipërfaqe të qëndrueshme (dritare, mur etj.).


Mbajeni antenat larg nga njësjia, kordoni elektrik dhe komponentët e tjerë për të shmangur kapjen e zhurmës.

Siguroni fundin e antenës përcjellëse FM me shirit ngjites.

## **Për të përgatitur antenën qarkore AM**



Hapni kordonin e antenës të mbledhur rreth antenës dhe ngrini mbështetësen e antenës.




Vendoseni antenën dhe sigurojeni në vendin përkatës sa të dëgjohet një kërcitje.

---

## **Lidhja e pajisjes iPod/iPhone/iPad ose USB**

Lidhni një pajisje iPod/iPhone/iPad ose USB me portën USB **18**.




Për të lidhur një iPod/iPhone/iPad\* me portën USB, përdorni një kablo USB të dhënë me iPod/iPhone/iPad tuaj.



\* Për iPod/iPhone/iPad që mund të përdorni me këtë sistem, shikoni "Modelet e përputhshme iPod/iPhone/iPad" (faqe 24).


## Përgatitja e një antene LAN me valë

Kur kryeni një lidhje me valë, vendoseni antenën me valë në pjesën e pasme të njësisë në pozicion vertikal.




### Shënim mbi treguesin e fuqisë së sinjalit LAN me valë

"" ndizet në ekranin  kur sistemi ndizet dhe kryhet lidhja LAN me valë në pikën e aksesit.\* Kontrolloni statusin e sinjalit LAN me valë dhe instaloni sistemin ku sinjali i marrë është i fortë. Sa më shumë segmente të ketë, aq më i fortë sinjali.

\* Shfaqet  për një lidhje rrjeti (LAN) me kablo.

# Vendosja e gominave të altoparlantëve


Vendosni gomat e dhëna të altoparlantëve në anën e poshtme të altoparlantëve që të mos rrëshqasin.





# Futja e baterive

Futni dy bateritë e dhëna R6 (përmasa AA),  
⊖ në fillim, duke përputhur polaritetet  
e treguara më poshtë.




## Shënime

- Me përdorim normal, bateritë duhet të zgjasin rreth 6 muaj.
- Mos përdorni bashkë një bateri të vjetër me një të re dhe mos përzieni lloje të ndryshme baterish.
- Nëse nuk e përdorni telekomandën për një periudhë të gjatë kohe, hiqni bateritë për të shmangur dëmtimet nga rrjedhja dhe gërryerja e baterive.

# Vendosja e orës

Vendosni orën me anë të butonave në telekomandë.



**1** Shtypni I/⏻ (energja) **1** për të ndezur sistemin.

**2** Shtypni TIMER MENU **19** për të zgjedhur modalitetin e cilësimit të orës.

Nëse "PLAY SET" pulson, shtypni ⬆/⬆ **24** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "CLOCK", dhe më pas shtypni ⊕ (hyrje) **33**.

**3** Shtypni ⬆/⬆ **24** në mënyrë të përsëritur për të vendosur orën, më pas shtypni ⊕ (hyrje) **33**.

---

**4** Përdorni të njëjtën procedurë për të cilësuar minutat.

## Shënim


Cilësimet e orës rivendosen kur shkëputni kordonin e rrymës ose nëse ndodh shkëputje e energjisë elektrike.

## Për të shfaqur orën kur sistemi është i fikur

Shtypni DISPLAY **28** në mënyrë të përsëritur për të shfaqur orën. Ora shfaqet për rreth 8 sekonda.

Nëse sistemi është në modalitetin e BLUETOOTH/gatishmërisë së rrjetit, ora nuk shfaqet kur shtypni DISPLAY **28**.

# Luajtja e një disku CD-DA/MP3



**1** Shtypni CD FUNCTION **4**.  
Shtypni FUNCTION **4** në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "CD" të shfaqet në ekranin **10**.

**2** Shtypni butonin ▲ (hap/mbyll) **15** për të hapur sirtarin e diskut **12**.

**3** Ngarkoni një disk me anën e etiketës lart.

**4** Shtypni butonin ▲ (hap/mbyll) **15** për të mbyllur sirtarin e diskut **12**.

**5** Shtypni butonin ►► (hap/mbyll) **6**.  
Fillon riprodhimi.



## Kur "NO DISC" shfaqet në ekran

Nuk keni vendosur disk në sirtarin e diskut ose keni vendosur një disk që nuk mund të riprodhohet në këtë sistem. Shikoni "Masat paraprake" (faqe 77) dhe vendosni një disk që mund të luhet.

## Shënime

- Nëse nuk mund ta hiqni diskun dhe në ekran shfaqet "LOCKED" [10], kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.
- Mos ngarkoni disqe me forma jostandarde (p.sh. në zemre, ylli). Kjo mund të shkaktojë dëmtime të riparueshme në sistem.
- Mos përdorni disqe me shirita, ngjitëse apo ngjitje mbi to duke qenë se kjo mund të shkaktojë keqfunksionim.
- Kur hiqni një disk, mos prekni sipërfaqen e diskut.

## Funksionimet e tjera

Për	Veproni si më poshtë:
Ndërprerjen e riprodhimit	Shtypni ►   [6]. Për të rifilluar luajtjen, shtypni sërish butonin.
Ndalimin e riprodhimit	Shtypni ■ [7].
Zgjedhjen e një pjese ose skedari	Shtypni ◀◀/▶▶ [8].
Gjetjen e një pike në një pjesë ose skedar	Mbani shtypur ◀◀/▶▶ [8] (ose ◀◀/▶▶ [8] në njësi) gjatë riprodhimit dhe lëshojeni butonin te pika e dëshiruar.
Zgjedhjen e luajtjes me përsëritje	Shtypni REPEAT [26] në mënyrë të përsëritur deri sa të shfaqen "↺" (të gjitha pjesët ose skedarët) ose "↺1" (një pjesë ose skedar).
Zgjedhjen e një dosjeje në një disk MP3	Shtypni 📁 +/- [24] në mënyrë të përsëritur.
Heqjen e një disku	Shtypni ▲ [15] në njësi.

## Për të ndryshuar modalitetin e luajtjes

Shtypni PLAY MODE [27] në mënyrë të përsëritur ndërkohë që luajtësi është i ndaluar. Ju mund të zgjidhni modalitetin e luajtjes normale (nuk shfaqet ndonjë tregues ose shfaqet "FLDR"\*), modalitetin e luajtjes me përzjerje (shfaqet "SHUF" ose "FLDR SHUF"\*) ose modalitetin e luajtjes së programit (shfaqet "PGM").

Modaliteti i luajtjes



- \* Kur shfaqet "FLDR" ose "FLDR SHUF", luhen të gjithë skedarët në dosjen e zgjedhur në diskun MP3.  
Kur luani një disk CD-DA, sistemi kryen të njëjtin funksion si luajtja normale (nuk ka tregues) ose luajtja me përzjerje "SHUF".

## Kur shfaqet "PUSH STOP"

Ju nuk mund ta ndryshoni modalitetin e luajtjes gjatë riprodhimit. Ndaloni riprodhimin dhe më pas ndryshoni modalitetin e luajtjes.

## Shënim mbi modalitetin e luajtjes

Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, modaliteti i luajtjes kthehet te luajtja normale.

## Shënime mbi luajtjen e përsëritur

- "↺" tregon se të gjitha pjesët ose skedarët do të përsëriten derisa të ndaloni riprodhimin.
- "↺1" tregon se një pjesë ose një skedar do të përsëritet derisa të ndaloni riprodhimin.
- Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, luajtja e përsëritur do të anulohet.

## Shënime mbi modalitetin e luajtjes së përzier


- Kur modaliteti i luajtjes së përzier vendoset në "SHUF", sistemi luan me përzierje të gjitha pjesët ose skedarët në disk. Kur modaliteti i luajtjes së përzier vendoset në "FLDR SHUF", sistemi luan me përzierje të gjitha pjesët ose skedarët në dosjen e zgjedhur.
- Kur fikni sistemin, modaliteti i përzgjedhur i luajtjes me përzierje ("SHUF" ose "FLDR SHUF") pastrohet dhe modaliteti i luajtjes kthehet në modalitetin e luajtjes normale (nuk ka tregues ose "FLDR").

## Shënime për luajtjen e disqeve MP3

- Mos ruani dosje ose skedarë të panevojshëm në një disk që ka skedarë MP3.
- Dosjet që nuk kanë skedarë MP3 nuk njihen në sistem.
- Sistemi mund të luajë vetëm skedarë MP3 që kanë një prapashtesë skedari ".mp3".
- Edhe kur emri i skedarit ka prapashtesën "mp3", nëse nuk është një skedar audio "MP3", luajtja e këtij skedari mund të gjenerojë një zhurmë të lartë që mund të shkaktojë dëmtim të sistemit.
- Numri maksimal i dosjeve dhe skedarëve MP3 të përputhshëm me këtë sistem është:
  - 999\* dosje (duke përfshirë dosjen rrënjë)
  - 999 skedarë
  - 250 skedarë në një dosje të vetme
  - 8 nivele dosjesh (në strukturë peme skedarësh)
- Nuk mund të garantohet pajtueshmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues të MP3, njësinë e CD-R/RW, pajisjet regjistruese dhe mjetet regjistruese. Disqet MP3 që nuk janë të pajtueshëm mund të prodhojnë zhurmë ose audio të ndërprerë ose mund të mos luhen fare.
- \* Kjo përfshin dosjet që nuk kanë MP3 ose skedarë të tjerë. Numri i dosjeve që sistemi mund të njohë mund të jetë më i vogël se numri aktual i dosjeve, në varësi të strukturës së dosjeve.

# Krijimi i programit personal (Luajtja e programit)

Programoni pjesët ose skedarët e zgjedhur duke përdorur butonat në telekomandë.



**1** Shtypni CD FUNCTION **4**.  
Shtypni FUNCTION **4** në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "CD" të shfaqet në ekranin **10**.


**2** Shtypni PLAY MODE **27** në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "PGM" të shfaqet për të zgjedhur modalitetin e luajtjes së programit kur luajtësi ka ndaluar.

**3** Zgjidhni një dosje (vetëm disk MP3).

- Shtypni **+/-** **24** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur dosjen e dëshiruar.
- Shtypni **⊕** **33** nëse dëshironi që të programoni të gjithë skedarët në dosje.

**4** Zgjidhni numrin e pjesës ose të skedarit të dëshiruar.

Shtypni **◀◀/▶▶** **8** në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet numri i pjesës ose i skedarit të dëshiruar.



**5** Shtypni **⊕** **33**.  
"- .- -" shfaqet kur koha totale e luajtjes kalon 100 minuta për një CD-DA ose kur programoni skedarë MP3.

## 6 Përsëritni hapat 3 deri 5 për të programuar më shumë pjesë ose skedarë.

Mund të programohen deri në 25 pjesë ose skedarë.

### Nëse shfaqet "STEP FULL"

Keni provuar të programoni 26 pjesë ose skedarë.

Fshini një pjesë ose skedar të programuar dhe programoni sërish pjesën e re ose skedarin.

Shihni "Për të fshirë programin" (faqe 23).

## 7 Shtypni ►|| 6.

Programi juaj për pjesët ose skedarët do të fillojë riprodhimin.

- Skedarët ose pjesët programuara mbeten të disponueshme derisa të hiqni diskut nga foleja e diskut ose të shkëputni kordonin e rrymës.
- Për të luajtur përsëri të njëjtin program, shtypni ►|| 6.

## Për të anuluar luajtjen e programit

Shtypni PLAY MODE 27 në mënyrë të përsëritur derisa "PGM" të zhduket gjatë kohës që luajtësi ka ndaluar.

## Për të fshirë programin

Shtypni CLEAR 31 gjatë kohës që luajtja ka ndaluar. Sa herë që shtypni butonin, do të fshihet pjesa e fundit e programuar: Kur të fshihen të gjitha pjesët ose skedarët e programuar, shfaqet "NO STEP".

### Shënime

- Nëse disku nxirret pas programimit, të gjitha pjesët ose skedarët e programuar do të fshihen.
- Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, pjesët ose skedarët e programuar do të fshihen.

# Luajtja e një iPod/iPhone/iPad

Ju mund të luani një iPod/iPhone/iPad duke e lidhur me sistemin. Ju mund ta përdorni iPod/iPhone/iPad duke përdorur butonat në këtë sistem.


## Modelet e përputhshme iPod/iPhone/iPad

Modelet iPod/iPhone/iPad që mund të përdoren me këtë sistem janë si më poshtë:

Modeli i përputhshëm	Lidhja USB	Lidhja AirPlay
iPod touch (5th generation)	✓	✓
iPod touch (4th generation)	✓	✓
iPod touch (3rd generation)	✓	✓
iPod nano (7th generation)	✓	–
iPod nano (6th generation)	✓	–
iPod nano (5th generation)	✓	–
iPod nano (4th generation)	✓	–
iPod classic	✓	–
iPhone 5	✓	✓
iPhone 4S	✓	✓
iPhone 4	✓	✓
iPhone 3GS	✓	✓
iPad (4th generation)	✓	✓
iPad mini	✓	✓
iPad (3rd generation)	✓	✓
iPad 2	✓	✓
iPad	✓	✓

duke filluar nga prilli 2013

“Made for iPod”, “Made for iPhone” dhe “Made for iPad” do të thonë se aksesori elektronik është krijuar për t'u lidhur posaçërisht e përkatësisht me iPod, iPhone ose iPad përkatësisht dhe është certifikuar nga prodhuesi për funksionimin në standardet e performancës së Apple. Apple nuk mban përgjegjësi për përdorimin e kësaj pajisjeje ose pajtueshmërinë e saj me standardet rregullatore dhe të sigurisë. Kini parasysh se përdorimi i këtij aksesori me iPod, iPhone, ose iPad mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.



**1** Shtypni USB FUNCTION [4]. Shtypni FUNCTION [4] në njësi në mënyrë të përsëritur derisa “USB” të shfaqet në ekranin [10].

**2** Lidhni kabllon USB të marrë me iPod/iPhone/iPad në portën USB [18] në njësi.



### 3 Lidhni kabllon USB të marrë me iPod/iPhone/iPad me iPod/iPhone/iPad.

Treguesi i funksionit në ekranin [10] ndryshon nga "USB" në "iPod".

### 4 Kur "iPod" të shfaqet në ekranin [10], shtypni ► [6] për të nisur riprodhimin.

#### Funksionimet e tjera

Ju mund të kryeni veprimet e mëposhtme duke përdorur butonat në telekomandën ose njësinë e sistemit.

Për	Veproni si më poshtë:
Ndërprerjen e riprodhimit	Shtypni ► [6] ose ■ [7]. Për të rifilluar luajtjen, shtypni sërish butonin.
Ndalimin e riprodhimit	Shtypni ■ [7].
Zgjedhjen e një pjese ose kapitulli të audio-librit/podkastit	Shtypni ◀◀/▶▶ [8].
Gjetjen e një pike në një pjesë ose kapitull të audiolibrit/podkastit	Mbani shtypur ◀◀/▶▶ [8] (◀◀/▶▶ [8] në njësi) gjatë riprodhimit dhe lëshojeni butonin te pika e dëshiruar.

#### Shënime

- Performanca e sistemit mund të ndryshojë, në varësi të specifikimeve të iPod/iPhone/iPad tuaj.
- Mos e transportoni sistemin me një iPod/iPhone/iPad të lidhur me sistemin. Duke vepruar kështu mund të shkaktoni keqfunksionim.
- Për të rregulluar nivelin e vullmit, përdorni VOLUME +/- [17] në telekomandë ose çelësin VOLUME [17] në njësi.
- Për të përdorur një iPod/iPhone/iPad, referojuni udhëzuesit të përdorimit të iPod/iPhone/iPad tuaj.
- Sony nuk mund të pranojë përgjegjësinë në rast se të dhënat e regjistruara në iPod/iPhone/iPad humbasin ose dëmtohen kur përdorni një iPod/iPhone/iPad me këtë sistem.

## Karikimi i një iPod/iPhone/iPad

Karikimi fillon automatikisht kur lidhni një iPod/iPhone/iPad me këtë sistem dhe sistemi është i ndezur.

### 1 Ndizni energjinë e sistemit. Shtypni I/⏻ [1] (energja) [1] për të ndezur sistemin.

### 2 Lidhni iPod/iPhone/iPad me portën USB në njësi. Për hollësi mbi lidhje, shikoni faqe 14.

Fillon karikimi i iPod/iPhone/iPad. Për detaje, referojuni udhëzuesit të përdorimit të iPod/iPhone/iPad tuaj.

#### Për të ndaluar karikimin e iPod/iPhone/iPad

Shtypni I/⏻ [1] për të fikur sistemin dhe më pas shkëputni iPod/iPhone/iPad.

#### Shënime për karikimin

- Ju nuk mund të karikoni një iPod/iPhone/iPad kur sistemi është i fikur.
- Nëse sistemi hyn në gjendjen e gatishmërisë gjatë karikimit të një iPod/iPhone/iPad, karikimi ndalon. Para karikimit çaktivizoni funksionin e gatishmërisë automatike. Për hollësi, shihni "Vendosja e funksionit të gatishmërisë automatike" (faqe 61).
- Për të parë nëse karikimi është funksional apo jo, kontrolloni ikonën e baterisë së ekranit të iPod/iPhone/iPad.

# Luajtja e një skedari në një pajisje USB

Ju mund të luani skedarët audio të ruajtur në një pajisje USB duke lidhur një memorie USB ose pajisje USB me sistemin. Formati audio që mund të luhet në këtë sistem është MP3/WMA\*/AAC\*. Kontrolloni uebsajtet e mëposhtme për informacion mbi pajisjet e pajtueshme USB. Për klientët në Evropë:

<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në vende/rajone të tjera:

<http://www.sony-asia.com/support>

\* Skedarët me mbrojtje të të drejtave të autorit DRM (Digital Right Management) ose skedarët e shkarkuar nga një dyqan muzikor online nuk mund të luhen në këtë sistem. Nëse provoni të luani një nga këto skedarë, sistemi luan skedarin të pambrojtur audio të radhës.

---

**1** Shtypni USB FUNCTION [4].  
Shtypni FUNCTION [4] në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "USB" të shfaqet në ekranin [10].


---

**2** Lidhni pajisjen USB drejtpërdrejt ose nëpërmjet kablllos USB të marrë me pajisjen USB me portën USB [18] në njësi.

---

**3** Shtypni ►|| [6] për të nisur riprodhimin.

---



## Funksionimet e tjera

Ju mund të kryeni veprimet e mëposhtme duke përdorur butonat në telekomandën ose njësinë e sistemit.

Për	Veproni si më poshtë:
Ndërprerjen e riprodhimit	Shtypni ►► [6]. Për të rifilluar luajtjen, shtypni sërish butonin.
Ndalimin e riprodhimit	Shtypni ■ [7]. Për të rifilluar luajtjen, shtypni ►► [6]*1. Për të anuluar rifillimin e riprodhimit, shtypni ■ [7] sërish*2.
Zgjedhjen e një dosjeje	Shtypni 📁 +/- [24] në mënyrë të përsëritur.
Zgjedhjen e një skedari	Shtypni ◀◀/▶▶ [8].
Gjetjen e një pike në një skedar	Mbani shtypur ◀◀/▶▶ [8] (◀◀/▶▶ [8] në njësi) gjatë riprodhimit dhe lëshojeni butonin te pika e dëshiruar.
Zgjedhjen e luajtjes me përsëritje	Shtypni REPEAT [26] në mënyrë të përsëritur deri sa të shfaqen "↺" (të gjithë skedarët audio) ose "↺1" (skedari audio i vetëm).

\*1 Kur luani një skedar VBR MP3/WMA sistemi mund të rifillojë riprodhimin nga një pikë tjetër.

\*2 Kur anulohet rifillimi i luajtjes, ekrani kthehet në numrin e dosjeve.

## Për të ndryshuar modalitetin e luajtjes

Shtypni PLAY MODE [27] në mënyrë të përsëritur ndërkohë që luajtësi është i ndaluar. Ju mund të zgjidhni modalitetin e luajtjes normale (nuk shfaqet ndonjë tregues ose shfaqet "FLDR"\*1), ose modalitetin e luajtjes me përzierje ("SHUF" ose "FLDR SHUF"\*2).

\*1 Kur nuk zgjidhet asnjë tregues, sistemi lexon të gjithë skedarët në pajisjen USB. Kur zgjidhet "FLDR", sistemi lexon të gjithë skedarët në dosjen e zgjedhur në pajisjen USB.

\*2 Kur zgjidhet "SHUF", sistemi lexon me përzierje të gjithë skedarët audio në pajisjen USB. Kur zgjidhet "FLDR SHUF", sistemi lexon me përzierje të gjithë skedarët audio në dosjen e zgjedhur.

## Shënim mbi modalitetin e luajtjes

Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, modaliteti i luajtjes kthehet te luajtja normale.

## Shënime mbi luajtjen e përsëritur

- "↺" tregon se të gjithë skedarët do të përsëriten deri sa të ndaloni riprodhimin.
- "↺1" tregon se një skedar do të përsëritet derisa të ndaloni riprodhimin.
- Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, luajtja e përsëritur do të anulohet.

## Shënime mbi modalitetin e luajtjes së përzierje

Kur fikni sistemin, modaliteti i përzgjedhur i luajtjes me përzierje ("SHUF" ose "FLDR SHUF") pastrohet dhe modaliteti i luajtjes kthehet në modalitetin e luajtjes normale (nuk ka tregues ose "FLDR").

## Shënime

- Rendi i riprodhimit për sistemin mund të ndryshojë nga rendi i riprodhimit të luajtësit dixhital muzikor të lidhur.
- Sigurohuni të fikni sistemin përpara se të hiqni pajisjen USB. Heqja e pajisjes USB gjatë kohës që sistemi është i ndezur, mund të prishë të dhënat në pajisjen USB.
- Kur nevojitet lidhja me kablllo USB, lidhni kabllon USB që keni marrë me pajisjen USB që do të lidhet. Për detaje mbi lidhjen, shihni manualin e përdorimit të dhënë me pajisjen USB që do të lidhet për detaje mbi mënyrën e funksionimit.
- Mund të duhet pak kohë përpara se të shfaqet "READING" pas lidhjes, në varësi të llojit të pajisjes USB të lidhur.
- Mos e lidhni pajisjen USB nëpërmjet një qendre USB.
- Kur lidhet pajisja USB, sistemi lexon të gjithë skedarët në pajisjen USB. Nëse ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB, mund të duhet shumë kohë që të përfundojë leximi i pajisjes USB.
- Për disa pajisje USB të lidhura mund të duhet më shumë kohë për të transmetuar sinjalet nga sistemi ose për të përfunduar leximin e pajisjes USB.
- Nuk mund të garantohet pajtueshmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues. Nëse skedarët audio në pajisjen USB janë koduar fillimisht me softuerë të papajtueshëm, ata skedarë mund të prodhojnë zhurmë ose mund të mos funksionojnë.

- Numri maksimal i dosjeve dhe skedarëve në pajisjen USB të përputhshme me këtë sistem është:
  - 1000\* dosje (duke përfshirë dosjen rrënjë)
  - 3000 skedarë
  - 250 skedarë në një dosje të vetme
  - 8 nivele dosjesh (në strukturë peme skedarësh)
- \* Kjo përfshin dosjet që nuk kanë skedarë audio që mund të luhen dhe që kanë dosje boshe. Numri i dosjeve që sistemi mund të njohë mund të jetë më i vogël se numri aktual i dosjeve, në varësi të strukturës së dosjeve.
- Sistemi nuk i mbështet domosdoshmërisht të gjitha funksionet e dhëna në pajisjen e lidhur USB.
- Dosjet që nuk kanë skedarë audio nuk njihen.
- Formatet audio që mund të dëgjoni me këtë sistem janë si më poshtë:
  - MP3: prapashtesa “.mp3”
  - WMA: prapashtesa “.wma”
  - AAC: prapashtesa “.m4a”, “.mp4” ose “.3gp”
 Vini re se edhe kur emri i skedarit ka një prapashtesë të saktë, nëse vetë skedari është i ndryshëm, sistemi mund të prodhojë zhurmë ose mund të keqfunksionojë.

## Karikimi i një pajisjeje USB

Karikimi fillon automatikisht kur lidhni një pajisje USB me këtë sistem dhe sistemi është i ndezur.

**1** Ndizni energjinë e sistemit. Shtypni I/⏻ (energjia) **1** për të ndezur sistemin.

**2** Lidhni një pajisje USB me portën USB në njësi.

Për hollësi mbi lidhje, shikoni faqe 14.

### Për të ndaluar karikimin e pajisjes USB

Shtypni I/⏻ **1** për të fikur sistemin dhe më pas shkëputni kabllon USB.

### Shënime për karikimin

- Ju nuk mund të karikoni një pajisje USB kur sistemi është i fikur. Disa pajisje USB mund të mos ngarkohen për shkak të karakteristikave të tyre.
- Nëse sistemi hyn në gjendjen e gatishmërisë gjatë karikimit të një pajisjeje USB, karikimi ndalon. Para karikimit çaktivizoni funksionin e gatishmërisë automatike. Për hollësi, shihni “Vendosja e funksionit të gatishmërisë automatike” (faqe 61).

# Përgatitja për lidhje BLUETOOTH

Ju mund të dëgjoni muzikë nga iPod/ iPhone/iPad ose pajisja juaj BLUETOOTH nëpërmjet një lidhje me valë. Para përdorimit të funksionit BLUETOOTH kryeni çiftimin për të regjistruar pajisjen tuaj BLUETOOTH.

Sistemi mbështet regjistrimin dhe lidhjen e pajisjes BLUETOOTH dhe NFC, e cila mundëson komunikimin me të dhëna thjesht duke prekur pajisjen tuaj në një vend të specifikuar. Për hollësi mbi NFC, shikoni "Lidhja me veprimin me një prekje (NFC)" (faqe 32).

## Çfarë është çiftimi?

Pajisjet BLUETOOTH që do të lidhen duhet të regjistrohen paraprakisht me njëra-tjetrën për t'u lidhur. Çiftimi është veprimi i regjistrimit të dy pajisjeve. Pasi të kryhet veprimi i çiftimit, ai nuk ka nevojë të kryhet sërish. Në rastet vijuese, sidoqoftë, veprimi i çiftimit duhet të kryhet sërish:

- Informacioni i çiftimit u fshi kur pajisja BLUETOOTH u riçiftua.
- Jeni përpjekur të çiftoni sistemin me më shumë se 10 pajisje BLUETOOTH.  
Ky sistem mund të çiftohet me deri në 9 pajisje BLUETOOTH. Nëse çiftoni një pajisje tjetër BLUETOOTH pas kryerjes së çiftimit me 9 pajisjet, informacioni i çiftimit të pajisjes që është lidhur me sistemin fillimisht mbishkruhet me atë në pajisjen e re.
- Është fshirë informacioni i regjistrimit të çiftimit së këtij sistemi nga pajisja e lidhur.
- Nëse e ndizni sistemin ose fshini historikun e çiftimit me sistemin, i gjithë informacioni i çiftimit do të fshihet.

## Rreth treguesit BLUETOOTH

Treguesi BLUETOOTH në qendrën e butonit BLUETOOTH [5] lejon kontrollimin e statusit të BLUETOOTH.

Statusi i sistemit	Ngjyra e treguesit	Statusi i treguesit
Sistemi është në gatishmërinë e BLUETOOTH (kur sistemi është i ndezur)	Blu	Pulson ngadalë.
Gjatë çiftimit BLUETOOTH	Blu	Pulson shpejt.
Sistemi po përpigjet të lidhet me një pajisje BLUETOOTH.	Blu	Pulson.
Sistemi ka krijuar një lidhje me një pajisje BLUETOOTH.	Blu	Qëndron ndezur.

Ky sistem mbështet BLUETOOTH A2DP (Advanced Audio Distribution Profile) dhe AVRCP (Audio Video Remote Control Profile). Për hollësi, shihni "Teknologjia BLUETOOTH me valë" (faqe 79).

## Shënime

- Për detaje mbi përdorimet e pajisjes BLUETOOTH që do të lidhni, referojuni manualit të përdorimit që shoqëron pajisjen tuaj BLUETOOTH.
- Pajisja BLUETOOTH që do të lidhet duhet të mbështesë A2DP (Advanced Audio Distribution Profile).



## Aktivizimi i marrjes së kodekut AAC

Ju mund të merrni të dhënat në formatin e kodekut AAC nga një pajisje BLUETOOTH. Për të aktivizuar marrjen, konfiguroni me anë të menysë së opsioneve.

- 1 Shtypni **OPTIONS** [34] për të shfaqur menynë e cilësimeve.
- 2 Shtypni **▲/▼** [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "BT AAC" më pas shtypni **+** [33].
- 3 Shtypni **▲/▼** [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "ON" ose "OFF", më pas shtypni **+** [33].  
**ON:** për të marrë në formatin e kodekut AAC  
**OFF:** për të marrë në formatin e kodekut SBC

### Shënime


- Në filloni konfigurimin gjatë lidhjes BLUETOOTH, lidhja do të ndërpritet.
- Kur përdorni një produkt Apple, përditësojeni me versionin e fundit të softuerit. Për detaje mbi përditësimin, referojuni manualit të përdorimit të dhënë me produktin tuaj Apple.
- Nëse zëri ndërpritet gjatë marrjes në formatin e kodekut AAC, vendoseni menynë BT AAC në "OFF."



- 1 Vendoseni pajisjen BLUETOOTH që do të lidhet brenda 1 metri nga sistemi.

## Çiftimi i sistemit me një pajisje BLUETOOTH

### Shebull lidhjeje



\* Kontrolloni nëse WALKMAN është pajisje BLUETOOTH apo jo, duke iu referuar manualit të përdorimit që shoqëron pajisjen tuaj WALKMAN.

- 2 Shtypni BLUETOOTH FUNCTION [4].  
Shtypni FUNCTION [4] në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "BT AUDIO" të shfaqet në ekranin [10].  
Treguesi BLUETOOTH pulson ngadalë në ngjyrë blu.
  - Nëse sistemi është lidhur automatikisht me pajisjen BLUETOOTH në të kaluarën, shtypni BLUETOOTH [5] në njësi për të anuluar lidhjen në mënyrë që "BT AUDIO" të shfaqet në ekranin [10].

### 3 Mbani shtypur BLUETOOTH [5] në njësi për 2 sekonda ose më shumë.

Treguesi BLUETOOTH pulson shpejt në ngjyrë blu dhe "PAIRING" pulson në ekranin [10].

Sistemi është në modalitetin e çiftimit.

### 4 Kryeni veprimin e çiftimit në pajisjen BLUETOOTH dhe kërkoni për këtë sistem me pajisjen BLUETOOTH.

Kur kërkimi të ketë përfunduar, një listë e pajisjeve të gjetura mund të shfaqet në ekranin e pajisjes BLUETOOTH.

- Ky sistem shfaqet si "SONY:CMT-SBT300W (Bluetooth)" ose "SONY:CMT-SBT300WB (Bluetooth)". Nëse nuk shfaqet, kryeni përsëri procedurën nga hapi 1.
- Kur krijoni lidhjen me këtë sistem, zgjidhni profilin audio (A2DP, AVRCP) në pajisjen BLUETOOTH.
- Nëse pajisja BLUETOOTH nuk e mbështet AVRCP (Profilin i kontrollit në largësi të audios e videos), nuk mund të kryeni riprodhimin ose ta ndaloni riprodhimin me këtë sistem.
- Për detaje mbi përdorimet e pajisjes BLUETOOTH që do të lidhni, referojuni manualit të përdorimit që shoqëron pajisjen tuaj BLUETOOTH.

### 5 Zgjidhni "SONY:CMT-SBT300W (Bluetooth)" ose "SONY:CMT-SBT300WB (Bluetooth)" në ekranin e pajisjes BLUETOOTH.

Nëse kërkohet që të futni një kod kalimi në pajisjen BLUETOOTH, futni "0000".

### 6 Përdorni pajisjen BLUETOOTH dhe realizoni lidhjen BLUETOOTH.

Kur çiftimi të ketë përfunduar dhe lidhja me pajisjen BLUETOOTH të jetë realizuar si duhet, ekranin [10] ndryshon në "BT AUDIO" nga "PAIRING" dhe treguesi BLUETOOTH [5] pulson ngadalë në blu.

- Në varësi të llojit të pajisjes BLUETOOTH, lidhja mund të nisët automatikisht pas përfundimit të çiftimit.

#### Shënime

- "Passkey" mund të quhet "Passcode", "PIN code", "PIN number" ose "Password", etj.
- Statusi në gatishmëri i çiftimit në sistem anulohet pas rreth 5 minutash. Nëse çiftimi nuk kryhet me sukses, kryeni sërish procedurën nga hapi 1.
- Nëse dëshironi që ta çiftojnë me disa pajisje BLUETOOTH, kryeni procedurën nga hapi 1 deri në 6 në mënyrë individuale për çdo pajisje BLUETOOTH.

#### Këshillë

Mund të kryeni një veprim çiftimi ose të përpiqeni të bëni një lidhje BLUETOOTH me një pajisje tjetër BLUETOOTH ndërkohë që po krijohet lidhja BLUETOOTH me një pajisje BLUETOOTH. Lidhja BLUETOOTH aktualisht e vendosur do të anulohet kur të krijohet me sukses lidhja BLUETOOTH me një pajisje tjetër.

### Për të spastruar informacionin e regjistrimit të çiftimit

#### 1 Shtypni BLUETOOTH FUNCTION [4].

- Shtypni FUNCTION [4] në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "BT AUDIO" të shfaqet në ekranin [10].
- Kur sistemi është i lidhur me një pajisje BLUETOOTH, emri i pajisjes i caktuar për pajisjen e lidhur BLUETOOTH shfaqet në ekranin [10] e sistemit. Shtypni BLUETOOTH [5] në njësi për të anuluar lidhjen me atë pajisje BLUETOOTH në mënyrë që "BT AUDIO" të shfaqet në ekranin [10].

#### 2 Shtypni OPTIONS [34] për të shfaqur menyën e cilësimeve.

#### 3 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "DEL LINK", më pas shtypni $\oplus$ [33].

#### 4 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "OK", më pas shtypni $\oplus$ [33].

"COMPLETE" shfaqet në ekranin [10] dhe fshihet i gjithë informacioni i çiftimit.

#### Shënim

Nëse i keni spastruar informacionet e çiftimit, nuk mund të kryeni një lidhje me BLUETOOTH nëse nuk kryeni përsëri çiftimin. Për t'u lidhur përsëri me një pajisje BLUETOOTH, duhet të futni kodin e kalimit në pajisjen BLUETOOTH.

## Lidhja me veprimin me një prekje (NFC)

NFC është një teknologji për komunikim me valë me reze të shkurtër mes pajisjeve të ndryshme, siç janë celularët dhe etiketat IC. NFC mundëson komunikimin me të dhëna thjesht duke prekur pajisjen tuaj në një vend të specifikuar.

Telefonat e përputhshëm smartphone janë ata telefona që janë të pajisur me funksionin NFC (sistemi operativ i përputhshëm: Android versioni 2.3.3 ose më i vonshëm me përjashtim të Android 3.x).

Kontrolloni sajtin e uebit më poshtë për informacione mbi pajisjet e përputhshme. Për klientët në Evropë:

<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në vende/rajone të tjera:

<http://www.sony-asia.com/support>

### Përgatitjet në telefonin tuaj smartphone (Android)

Një aplikacion i përputhshëm me NFC duhet të instalohet në telefonin tuaj smartphone. Nëse nuk është i instaluar, mund të shkarkoni "NFC Easy Connect" nga Google Play.

- Në disa vende dhe rajone, aplikacioni i përputhshëm me NFC mund të mos shkarkohet.
- Për disa telefona smartphone, ky funksion mund të jetë i disponueshëm pa shkarkuar "NFC Easy Connect". Në këtë rast, përdorimi dhe specifikimet e telefonit smartphone mund të jenë ndryshe nga përshkrimi në këtë manual. Për detaje, referojuni udhëzuesit të përdoruesit që shoqëron telefonin tuaj smartphone.

- 1 Hyni në sajtin e uebit më poshtë për të instaluar aplikacionin.

<https://play.google.com/store/apps/details?id=com.sony.easyconnect>

### Nëse hyni me anë të kodit 2D

Lexoni 2D Code që vijon për ta hapur.



- 2 Caktojini telefonin smartphone që të aktivizojë funksionin NFC.

Për detaje, referojuni udhëzuesit të përdoruesit që shoqëron telefonin tuaj smartphone.

### Rreth aplikacionit "NFC Easy Connect"

Ky është një aplikacion falas i përdorur veçanërisht për Android. Kërkonte në internet për informacione të detajuara mbi "NFC Easy Connect" dhe shkarkoni aplikacionin.

- Në disa vende dhe rajone, aplikacioni i përputhshëm me NFC mund të mos shkarkohet.

### Kryerja e një lidhjeje me telefonin tuaj smartphone me një prekje


Thjesht prekni telefonin tuaj smartphone me sistemin. Sistemi aktivizohet automatikisht dhe do të kryhet çiftimi dhe lidhja BLUETOOTH.

- 1 Nisni aplikacionin "NFC Easy Connect" në telefonin smartphone.

Sigurohuni që të shfaqet ekrani i aplikacionit.

- 2 Prekni telefonin tuaj smartphone me njësinë.

Prekni telefonin smartphone me shenjën N në njësi dhe ruani kontaktin deri sa telefoni smartphone të dridhet.



Përfundoni lidhjen me telefonin smartphone duke ndjekur udhëzimet në ekran.

Referojuni udhëzuesit të përdoruesit të telefonit për pjesën e telefonit smartphone që përdoret si kontakt me prekje.



### **Për të shkëputur me veprimin me një prekje**

Për të shkëputur lidhjen e vendosur, prekni telefonin smartphone me shenjën N në njësi.

### **Për të ndezur një pajisje të lidhur me veprimin me një prekje**

Kur prekni një telefon smartphone të përputhshëm për NFC me njësinë ndërkohë që një pajisje tjetër BLUETOOTH është e lidhur me këtë sistem, pajisja BLUETOOTH shkëputet dhe sistemi lidhet me telefonin smartphone.


Nëse prekni telefonin smartphone e lidhur me këtë sistem me një kufje ose altoparlant tjetër BLUETOOTH të përputhshëm me NFC, telefoni smartphone shkëputet nga sistemi dhe lidhet me pajisjen BLUETOOTH që keni prekur.

# Dëgjimi i muzikës nëpërmjet një lidhjeje BLUETOOTH

Ju mund të përdorni një pajisje BLUETOOTH të çiftuar me sistemin dhe të luani muzikë përmes një pajisjeje BLUETOOTH. Ju mund të rregulloni volumin e sistemit dhe të kryeni veprimin e luajtjes/ndalimit duke përdorur pajisjen e lidhur BLUETOOTH. Për detaje mbi përdorimin, referojuni manualit të përdorimit të dhënë me pajisjen tuaj BLUETOOTH.

Konfirmoni të mëposhtmet përpara se të luani muzikë:

- Funkzioni BLUETOOTH i pajisjes BLUETOOTH është i aktivizuar.
- Çiftimi me sistemin është kryer.



## 1 Shtypni BLUETOOTH FUNCTION **4**.

Treguesi BLUETOOTH pulson ngadalë në ngjyrë blu.

- Shtypni FUNCTION **4** në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "BT AUDIO" të shfaqet në ekranin **10**.

## 2 Realizoni lidhjen BLUETOOTH me pajisjen BLUETOOTH.

Pasi të kryhet lidhja, "CONNECT" shfaqet në ekranin **10** më pas shfaqet emri i vendosur në pajisjen e lidhur BLUETOOTH.

- Nëse pajisja BLUETOOTH është lidhur me këtë sistem në të kaluarën, ajo mund të lidhet automatikisht pa patur nevojë për veprime nga përdoruesi.
- Për detaje mbi përdorimet e pajisjes BLUETOOTH, referojuni manualit të përdorimit që shoqëron pajisjen tuaj BLUETOOTH.

## 3 Shtypni **▶|| 6** për të nisur riprodhimin.

- Në varësi të pajisjes BLUETOOTH, mund të duhet të hapni paraprakisht një lexues muzikor paraprakisht në pajisjen BLUETOOTH.
- Në varësi të pajisjes BLUETOOTH, mund të duhet të shtypni **▶|| 6** dy herë.

## 4 Shtypni VOLUME +/- **17** për të rregulluar volumin.

- Rrotulloni çelësin VOLUME **17** në njësi majtas ose djathtas për të rregulluar volumin.
- Nëse volumi nuk ndryshohet dot, rregullojeni te pajisja juaj BLUETOOTH.

## Funksionimet e tjera

Ju mund të kryeni veprimet e mëposhtme duke përdorur butonat në telekomandën ose njësinë e sistemit.

Për	Veproni si më poshtë:
Ndërprerjen e riprodhimit	Shtypni ►   [6]*.
Ndalimin e riprodhimit	Shtypni ■ [7].
Zgjedhjen e një dosjeje	Shtypni 📁 +/- [24].
Zgjedhjen e një skedari	Shtypni ◀◀/▶▶ [8].
Gjetjen e një pike në një skedar	Mbani shtypur ◀◀/▶▶ [8] (ose ◀◀/▶▶ [8] në njësi) gjatë riprodhimit dhe lëshojeni butonin te pika e dëshiruar.

\* Në varësi të pajisjes BLUETOOTH mund të duhet të shtypni ►|| [6] dy herë.

### Shënim

Veprimet e përshkruara në këtë manual mund të mos jenë të disponueshme për disa pajisje të caktuara BLUETOOTH. Përveç kësaj, veprimet reale mund të ndryshojnë në varësi të pajisjes BLUETOOTH të lidhur.

### Për të kontrolluar adresën e një pajisjeje BLUETOOTH të lidhur

Shtypni DISPLAY [28] ndërkohë që emri i pajisjes BLUETOOTH të caktuar në pajisjen BLUETOOTH të lidhur shfaqet në ekranin [10]. Adresa e pajisjes BLUETOOTH shfaqet në dy vendosje në ekran për 8 sekonda.

### Për të anuluar lidhjen me pajisjen BLUETOOTH

Shtypni BLUETOOTH [5] në njësi. "DISCONNECT" shfaqet në ekranin [10]. Në varësi të pajisjes BLUETOOTH, lidhja mund të anulohet automatikisht kur ndaloni riprodhimin.

# Si të lidhni rrjetin

Konfiguroni rrjetin pasi të keni kontrolluar mjedisin e rrjetit. Referojuni përshkrimeve të mëposhtme.

## Konfigurimi për një rrjet me valë

Zgjidhni metodën e përshtatshme dhe filloni të kryeni cilësimet e rrjetit. Mos lidhni kablo rrjeti (LAN) me sistemin.

- Opsioni 1: Metoda për përdorimin e një aplikacioni për telefona smartphone ose tableta (pajisje Android/iPhone/iPod touch/iPad) (faqe 37)
- Opsioni 2: Konfigurimi manual duke përdorur Access Point Scan (Skanimin e pikës së aksesit) (për PC/Mac) (faqe 38)
- Opsioni 3: Metoda për përdorimin e një butoni WPS në pikën e aksesit që mbështet WPS (faqe 40)

## Konfigurimi për një rrjet me kablo

- Opsioni 4: Metoda DHCP (faqe 41)

### Këshillë

Për të lidhur adresën fikse IP dhe për të konfiguruar serverin përfaqësues, përdorni ekranin në hapin 8 të "Opsioni 2: Konfigurimi manual duke përdorur Access Point Scan (Skanimin e pikës së aksesit) (për PC/Mac)" (faqe 38).

# Konfigurimi për një rrjet me valë

## Shënim

Kur konfiguroni një rrjet me valë, mund të kërkohet SSID (Emri i rrjetit me valë) dhe çelësi i sigurisë (çelësi WEP ose WPA). Çelësi i sigurisë (ose çelësi i rrjetit) është një çelës enkriptimi që përdoret për të kufizuar pajisjet me të cilat mund të kryhet komunikimi. Ai përdoret për të ofruar siguri më të lartë për pajisjet që komunikojnë përmes një ruteri LAN me valë/pike aksesi.

## Opsioni 1: Metoda për përdorimin e një aplikacioni për telefona smartphone ose tableta (pajisje Android/iPhone/iPod touch/iPad)

### Shënime

- Përpara se të nisni këtë procedurë, kini parasysh se rrjeti juaj Wi-Fi do të jetë i pambrojtur derisa të kryhet konfigurimi. Pasi të kryhet konfigurimi, rrjeti juaj Wi-Fi do të mbrohet sërish kur vendosni sigurinë me valë LAN.
- Procedura e mëposhtme duhet të kryhet brenda 30 minutash. Nëse nuk arrini ta përfundoni, fikni sistemin dhe nisni sërish nga hapi 1.
- Nëse keni probleme gjatë konfigurimit të rrjetit, filloni nga hapi 1.

- 1** Duhet të keni gati emrin e rrjetit me valë (SSID) dhe çelësin e sigurisë për ruterin LAN me valë/pikën e aksesit për referencë.

SSID (Emri i rrjetit me valë)

Çelësi i sigurisë (çelësi WEP ose WPA)

Për SSID dhe çelësin e sigurisë, referojuni udhëzimeve të përdorimit të ruterit LAN me valë/pikës së aksesit.

- 2** Shkarkoni aplikacionin “NS Setup”.



Ju mund të shkarkoni aplikacionin falas nga “Google Play” për pajisjet Android ose “App Store” për pajisjet iPhone/iPod touch/iPad në uebsajt.

### Android

<https://play.google.com/store/apps/details?id=com.sony.nssetup.app>

### iOS

<https://itunes.apple.com/au/app/ns-setup/id537150314?mt=8>

### Nëse hyni me anë të kodit 2D

Lexoni 2D Code që vijon për ta hapur.

### Android



### iOS



Ju mund ta kërkonte aplikacionin me lehtësi nëse shkruani “NS Setup” në ekranin e kërkimit.

- 3** Shtypni I/⏻ (energjia) **1** për të nderur sistemin.

---

**4** Shtypni **OPTIONS** **[34]** për të shfaqur menynë e cilësimeve.

---

**5** Shtypni **↑/↓** **[24]** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur “NW RESET”, më pas shtypni **+** **[33]**. Kur “OK” shfaqet në ekran, shtypni **+** **[33]**.  
Sistemi fiket automatikisht.

---

**6** Shtypni **I/⏻** (energji) **[1]** për të ndezur sistemin.  
Kur **📶** të pulsojë në ekranin **[10]**, kryeni veprimin e mëposhtëm.

**Kur konfiguroni me një iPhone/iPod touch/iPad**

Nga ekrani kryesor shkoni te [Settings] (Cilësimet) – [Wi-Fi] dhe zgjidhni “Sony\_Wireless\_Audio\_Setup.”  
Nëse nuk shfaqet “Sony\_Wireless\_Audio\_Setup”, prisni derisa **📶** të pulsojë në ekranin **[10]**, më pas kryeni sërish kërkimin.

---

**7** Nisni aplikacionin “NS Setup”.

---

**8** Kryeni konfigurimin duke ndjekur udhëzimet në ekran.  
Kur të kryhet konfigurimi, shtypni butonin “Play test sound” për të konfirmuar veprimin e sistemit duke luajtur sinjalin e testimit.

**Shënime**

- Nëse “Sony\_Wireless\_Audio\_Setup” nuk shfaqet, përsëritni hapat 4 e në vazhdim.
- Mos e lidhni kabllon e rrjetit (LAN).

---

## Opsioni 2: Konfigurimi manual duke përdorur Access Point Scan (Skanimin e pikës së aksesit) (për PC/Mac)

**Shënim**

Kini parasysh se rrjeti juaj Wi-Fi do të jetë i pambrojtur derisa të kryhet konfigurimi. Pasi të kryhet konfigurimi, rrjeti juaj Wi-Fi do të mbrohet sërish kur vendosni sigurinë me valë LAN.

---

**1** Duhet të keni gati emrin e rrjetit me valë (SSID) dhe çelësin e sigurisë për ruterin LAN me valë/pikën e aksesit për referencë.

SSID (Emri i rrjetit me valë)

---

Çelësi i sigurisë (çelësi WEP ose WPA)

---

Për SSID dhe çelësin e sigurisë, referojuni udhëzimeve të përdorimit të ruterit LAN me valë/pikës së aksesit.

---

**2** Shtypni **OPTIONS** **[34]** për të shfaqur menynë e cilësimeve.

---

**3** Shtypni **↑/↓** **[24]** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur “NW RESET”, më pas shtypni **+** **[33]**.  
Sistemi fiket automatikisht.


---

**4** Shtypni **I/⏻** (energji) **[1]** për të ndezur sistemin.

---


## 5 Lidhni njësinë dhe një Mac ose PC.



### Për Mac OS X

- ①Ndizni Mac.
- ②Zgjidhni ikonën  në krye të ekranit.
- ③Zgjidhni [Sony\_Wireless\_Audio\_Setup] nga lista e rrjeteve.



### Për Windows 8 (Ndërfaqja e Windows)

- ①Ndizni PC.
- ②Lëvizni shigjetën e mausit në këndin e djathtë lart (ose këndin e djathtë poshtë) të ekranit Start (Nisja) për të shfaqur simbolet dhe zgjidhni [Settings] (Cilësimet).  
Me një panel me prekje, shfaqni simbolet duke rrëshqitur nga fundi i djathtë i ekranit Start (Nisja) dhe zgjidhni [Settings] (Cilësimet).




- ③Zgjidhni ose trokitni ikonën  ose .
- ④Zgjidhni [Sony\_Wireless\_Audio\_Setup] nga lista e rrjeteve.

### Për Windows 7/Windows 8


- ①Ndizni PC.
- ②Klikoni ose trokitni desktopin në ekranin Start (Nisja).
- ③Zgjidhni ikonën  ose  në fund të ekranit.
- ④Zgjidhni [Sony\_Wireless\_Audio\_Setup] nga lista e rrjeteve.

### Për Windows Vista

- ①Ndizni PC.
- ②Klikoni ikonën  në fund të ekranit.
- ③Zgjidhni [Connect to a network] (Lidhu me një rrjet).
- ④Zgjidhni [Sony\_Wireless\_Audio\_Setup] nga lista e rrjeteve.

## 6 Hyni në ekranin [Sony Network Device Setting] (Cilësimi i pajisjeve të rrjetit Sony).

### Për Mac


Nisni Safari dhe zgjidhni [Bonjour] te  ([Bookmarks] (Faqeshënuesit)), më pas zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B) XXXXXX].

### Për PC

Nisni shfletuesin dhe futni ose URL-të e mëposhtme në shiritin e adresës së shfletuesit.



## 7 Zgjidhni gjuhën e dëshiruar kur shfaqet ekranin [Language Setup] (Konfigurimi i gjuhës).



## 8 Zgjidhni [Network Settings] (Cilësimet e rrjetit) nga menyuja.



Cilësimet e rrjetit

## 9 Zgjidhni SSID të ruterit LAN me valë/pikës së aksesit, më pas futni çelësin e sigurisë (nëse ka).



SSID

## 10 Zgjidhni [Apply] (Apliko).

## 11 Zgjidhni [OK] në dritaren e shfaqur.

Sistemi rindizet automatikisht.

## 12 Lidhni Mac ose PC me ruterin LAN me valë/pikën e aksesit që do të përdoret.

### Shënim

Kjo procedurë duhet të kryhet brenda 30 minutash. Nëse nuk arrini ta përfundoni, fikni sistemin dhe nisni sërish nga hapi 1.

## Opsioni 3: Metoda për përdorimin e një butoni WPS në pikën e aksesit që mbështet WPS

### 1 Kontrolloni nëse është shkëputur kabloja (LAN) e rrjetit (nuk është e përfshirë).

Shkëputni kabllo të rrjetit (LAN) gjatë kohës që kordoni elektrik është i shkëputur nëse kabloja e rrjetit (LAN) është e lidhur.

### 2 Shtypni OPTIONS **[34]** për të shfaqur menunë e cilësimeve.


### 3 Shtypni **▲/▼ [24]** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "WPS", më pas shtypni **⊕ [33]**.

"OK" shfaqet në ekranin **[10]**.

- Për të anuluar cilësimin, shtypni **▲/▼ [24]** për të zgjedhur "CANCEL", më pas shtypni **⊕ [33]**.

### 4 Shtypni **⊕ [33]**. Pulson "WPS".

### 5 Shtypni butonin WPS në pikën e aksesit.



\* Pozicioni dhe forma e butonit WPS janë të ndryshme në varësi të modelit të pikës së aksesit.

### Këshillë

Referojuni udhëzimeve të përdorimit të ruterit LAN me valë/pikës së aksesit për detaje mbi butonin WPS.



# Konfigurimi i rrjeteve me kablo

---

## Opsioni 4: Metoda DHCP

Zakonisht, cilësimi i DHCP vendoset në ON (Ndezur) kur lidhni kompjuterin me rrjetin. Provoni metodën e mëposhtme nëse përdorni një rrjet me kablo. Vendoseni paraprakisht cilësimin e DHCP në kompjuter në ON (Ndezur).

- 
- 1** Kontrolloni nëse kompjuteri dhe ruteri janë të aktivizuar.


---

  - 2** Lidhni sistemin dhe ruterin duke përdorur kabllon e rrjetit (LAN) (nuk është e përfshirë).

---

  - 3** Lidhni ruterin dhe kompjuterin duke përdorur kabllon e dytë të rrjetit (LAN) (nuk është e përfshirë) ose një lidhje LAN me valë.

Kabloja e rrjetit (LAN)  
(nuk është e përfshirë)  
ose një lidhje LAN me valë




Kabloja e rrjetit (LAN)  
(nuk është e përfshirë).

- 
- 4** Ndizni sistemin.  
Ndizet në ekranin **10** kur vendoset lidhja.

# Dëgjimi i materialeve audio duke përdorur DLNA (Digital Living Network Alliance)

Ju mund të luani materiale audio në serverë të përputhshëm me DLNA si p.sh. në kompjuter, regjistruar rrjeti, etj., në këtë sistem duke kontrolluar serverin përmes aplikacionit "Network Audio Remote"\*. Për këtë nevojitet një pajisje komandimi e përputhshme me DLNA- (një telekomandë, etj.). Ju mund të përdorni Windows 7/Windows 8 edhe si server edhe si komandues.



\* Network Audio Remote është aplikacion për iOS dhe Android. Sony e ofron aplikacionin "Network Audio Remote" falas.

Për detaje, referojuni uebsajtit të mëposhtëm.

Ju mund të shkarkoni aplikacionin falas nga "Google Play" për pajisjet Android ose "App Store" për pajisjet iPhone/iPod Touch/iPad në uebsajt.

Ju mund ta kërkonit aplikacionin me lehtësi nëse shkruani "Network Audio Remote" në ekranin e kërkimit.

## Android

<https://play.google.com/store/apps/details?id=com.sony.nar.app>

## iOS

<http://itunes.apple.com/us/app/network-audio-remote/id398312883?mt=8>

## Nëse hyni me anë të kodit 2D

Lexoni 2D Code që vijon për ta hapur.

## Android



## iOS



Sistemi të luajë materiale audio të ruajtura në server duke përdorur marrësin në formate MP3, Linear PCM, WMA dhe AAC\*. Materiale audio të mbrojtura nga e drejta e autorit DRM (Digital Rights Management) nuk mund të luhen në këtë sistem.

\* Sistemi mund të luajë vetëm skedarë AAC me prapashtesë ".m4a", ".mp4" ose ".3gp".

## Shënime

- Në përgjithësi, mund të duhet pak kohë për të njohur secilën pajisje të përputhshme me DLNA- që aktualisht përdoret kur shijoni materiale audio përmes një rrjeti në shtëpi.
- Ky sistem nuk mund të luajë skedarë të formatit WMA të mbrojtur me të drejta autori DRM. Nëse një skedar WMA nuk mund të riprodhohet në këtë sistem, kontrolloni pronësinë e skedarit në kompjuterin tuaj dhe shikoni nëse ka të drejta autori DRM.  
Hapni një dosje ose volum ku ruhet skedari WMA dhe klikoni me të djathtën mbi skedar për të shfaqur dritaren [Property] (Vetitë). Kur ka skedë [Licence] (Licenca), skedari mbrohet me të drejta autori DRM dhe nuk mund të luhet në këtë sistem.
- Ju nuk mund të luani disa materiale me produktet DLNA CERTIFIED.

## Këshillë

Funksioni i rrjetit është i disponueshëm duke luajtur materialet audio në server të përputhshëm me DLNA ose telekomandë, megjithëse nuk mund ta zgjidhni duke përdorur butonat e funksionit në njësinë e këtij sistemi.

## Dëgjimi i materialeve audio në kompjuter me Windows 8

Windows 8 mbështet DLNA 1.5. Windows 8 mund të përdoret si server dhe komandues. Ju mund të dëgjoni materiale audio në server me lehtësi duke përdorur funksionin [Play To] (Luaj në) të Windows 8.



Komanduesi/serveri DLNA (kompjuteri i platformës Windows 8)

Luajtësi i komanduar në rrjet (ky sistem)

### Shënimi



Elementët e shfaqur në kompjuter mund të ndryshojnë nga ato në këtë pjesë, në varësi të versionit të sistemit operativ ose ambientit të kompjuterit. Për detaje, referojuni udhëzuesit të ndihmës të kompjuterit tuaj.

## Konfigurimi i një kompjuteri me Windows 8


- 1 Lëvizni shigjetën e mausit në këndin e djathtë lart (ose këndin e djathtë poshtë) të ekranit Start (Nisja) për të shfaqur simbolet dhe zgjidhni [Settings] (Cilësimet).

Me një panel me prekje, shfaqni simbolet duke rrëshqitur nga fundi i djathtë i ekranit të nisjes dhe zgjidhni [Settings] (Cilësimet).



- 2 Zgjidhni ikonën  ose .

- 3 Klikoni me të djathtën emrin e rrjetit të lidhur ose mbajeni shtypur dhe zgjidhni [Turn sharing on or off] (Aktivizo ose çaktivizo ndarjen).



- 4 Zgjidhni [Yes, turn on sharing and connect to devices] (Po, aktivizo ndarjen dhe lidh me pajisjet).



## Dëgjimi i materialeve audio të ruajtura në kompjuter me Windows 8


Përdorimi i "Music" (Muzikë) të Windows 8 (Windows UI)

- 1 Zgjidhni [Music] (Muzikë) në ekranin Start (Nisja).




- 2 Zgjidhni materialin e dëshiruar audio dhe luajeni.

- 3 Lëvizni shigjetën e mausit në këndin e djathtë lart (ose këndin e djathtë poshtë) të ekranit Start (Nisja) për të shfaqur simbolet dhe zgjidhni [Devices] (Pajisjet). Me një panel me prekje, shfaqni simbolet duke rrëshqitur nga fundi i djathtë i ekranit e nisjes dhe zgjidhni [Devices] (Pajisjet).



- 4 Zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B)XXXXXX].


Sistemi kalon në modalitetin e funksionit të rrjetit dhe luhet materiali i zgjedhur audio.




Përdorimi i Windows Media Player

- 1 Klikoni me të djathtë në ekranin Start (Nisja).

Me një panel me prekje, rrëshqitni ekranin Start (Nisja) nga poshtë-lart dhe zgjidhni [All apps] (Të gjitha aplikacionet) në të djathtë në fund të ekranit.




## 2 Zgjidhni [Windows Media Player].




## 3 Klikoni me të djathtën materialin e dëshiruar audio ose mbajeni të shtypur.

## 4 Zgjidhni [Play To] (Luaj në) nga menya.



Shfaqet lista e pajisjeve.

## 5 Zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B) XXXXXX].




Sistemi kalon në modalitetin e funksionit të rrjetit dhe luhet materiali i zgjedhur audio.


## Konfigurimi i komanduesit DLNA për përdorim me këtë PC

## 1 Klikoni me të djathtën në ekranin Start (Nisja).


Me një panel me prekje, rrëshqitni ekranin Start (Nisja) nga poshtë-lart dhe zgjidhni [All apps] (Të gjitha aplikacionet) në të djathtë në fund të ekranit.




## 2 Zgjidhni [Windows Media Player].



## 3 Klikoni ose trokitni mbi [Stream] (Transmetimi) dhe zgjidhni [More streaming options] (Më shumë opsione transmetimi).



## 4 Kontrolloni nëse të gjitha pajisjet lejohen.




Nëse jo, zgjidhni [Allow All] (Lejo të gjitha) dhe hapni ekranin [Allow All Media Devices] (Lejo të gjitha pajisjet media). Zgjidhni [Allow all the PCs and Media Devices] (Lejo të gjitha pajisjet PC dhe media).

## 5 Zgjidhni [OK] për të mbyllur ekranin.

Cilësimi tani është kryer. Ju mund të dëgjoni muzikën e ruajtur në PC tuaj duke përdorur komanduesin DLNA.

## Dëgjimi i materialeve audio në kompjuter me Windows 7

Windows 7 mbështet DLNA 1.5. Windows 7 mund të përdoret si server dhe komandues. Ju mund të dëgjoni materiale audio në server me lehtësi duke përdorur funksionin [Play To] (Luaj në) të Windows 7.



Komanduesi/serveri DLNA (kompjuter i platformës Windows 7)

Luajtës i komanduar në rrjet (ky sistem)

## Shënim

Elementët e shfaqur në kompjuter mund të ndryshojnë nga ato në këtë pjesë, në varësi të versionit të sistemit operativ ose ambientit të kompjuterit. Për detaje, referojuni udhëzuesit të ndihmës të kompjuterit tuaj.


## Konfigurimi i një kompjuteri me Windows 7

- 1 Shkoni te [Start] (Nisja) – [Control Panel] (Paneli i kontrollit) dhe zgjidhni [View network status and tasks] (Shiko statusin e rrjetit dhe detyrat) te [Network and Internet] (Rrjeti dhe interneti). Shfaqet ekrani [Network and Sharing Center] (Qendra e rrjetit dhe e ndarjes).

### Këshillë

Nëse artikulli që dëshironi nuk shfaqet në ekran, përpikuni të ndryshoni llojin e Control Panel (Panelit të Kontrollit).

- 2 Zgjidhni [Public network] (Rrjet publik) te [View your active networks] (Shiko rrjetet aktive). Nëse ekrani shfaq ndryshe nga [Public network] (Rrjet publik), kaloni në hapin 5.




Shfaqet ekrani [Set Network Location] (Vendos vendndodhjen e rrjetit).

- 3 Zgjidhni [Home network] (Rrjeti i shtëpisë) ose [Work network] (Rrjeti i punës) në varësi të ambientit ku përdoret sistemi.


- 4 Ndiqni udhëzimet që shfaqen në ekran në varësi të ambientit ku përdoret sistemi.

Kur kryhet ndryshimi, konfirmo nëse artikulli te [View your active networks] (Shiko rrjetet e tua aktive) është bërë [Home network] (Rrjeti i shtëpisë) ose [Work network] (Rrjeti i punës) në ekranin [Network and Sharing Center] (Qendra e ndarjes dhe e rrjetit).

- 5 Zgjidhni [Change advanced sharing settings] (Ndrysho cilësimet e përparuara të ndarjes).




- 6 Zgjidhni [Choose media streaming options...] (Zgjidh opsionet e transmetimit të medias) nga [Media streaming] (Transmetimi i medias).



**7** Nëse në ekranin e opsioneve të transmetimit të medias shfaqet [Media streaming is not turned on] (Transmetimi i medias nuk është aktivizuar) zgjidhni [Turn on media streaming] (Aktivizo transmetimin e medias).

**8** Zgjidhni [Allow All] (Lejo të gjitha).



Hapet ekrani [Allow All Media Devices] (Lejo të gjitha pajisjet media). Nëse të gjitha pajisjet në rrjetin lokal janë të caktuara në [Allowed] (Lejuar), zgjidhni [OK] dhe mbyllni ekranin.

**9** Zgjidhni [Allow all computers and media devices] (Lejo të gjithë kompjuterët dhe pajisjet media).


**10** Zgjidhni [OK] për të mbyllur ekranin.

## Dëgjimi i materialeve audio të ruajtura në kompjuter me Windows 7

**1** Filloni [Windows Media Player] të Windows 7.


**2** Zgjidhni materialin e dëshiruar audio, më pas klikoni me butonin e djathtë të mausit.

**3** Zgjidhni [Play To] (Luaj në) nga menyja.



Shfaqet lista e pajisjeve.

**4** Zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B) XXXXXX].



Sistemi kalon në modalitetin e funksionit të rrjetit dhe luhet materiali i zgjedhur audio.



## Dëgjimi i materialeve audio në kompjuter me Windows Vista/Windows XP

Duhet të konfiguroni Windows Media Player 11 për të dëgjuar muzikë duke përdorur Windows Vista/Windows XP\* si server.

\* Windows Media Player 11 nuk është instaluar nga prodhuesi tek Windows XP. Futuni në uebsajtin e Microsoft, shkarkoni instaluesin dhe instaloni më pas Windows Media Player 11 në kompjuterin tuaj. Përditësoni versionin e softuerit të kompjuterit tuaj në XP Service Pack 2 ose version të mëvonshëm, më pas instaloni Windows Media Player 11. Nuk mund ta instaloni Windows Media Player 11 në versionet e XP përpara Service Pack 2.


### Shënim

Elementët e shfaqur në kompjuter mund të ndryshojnë nga ato në këtë pjesë, në varësi të versionit të sistemit operativ ose ambientit të kompjuterit. Për detaje, referojuni udhëzuesit të ndihmës të kompjuterit tuaj.

## Konfigurimi i një kompjuteri me Windows Vista/Windows XP


- 1 Shkoni te [Start] (Nisja) – [All Programs] (Të gjitha programet) dhe zgjidhni [Windows Media Player]. Windows Media Player 11 fillon.
- 2 Zgjidhni [Media Sharing...] (Ndarja e medias) nga menjya [Library] (Biblioteka). Nëse jeni duke përdorur Windows XP, shkoni te hapi 8.

- 3 Kur shfaqet , zgjidhni [Networking...] (Rrjeti).




Shfaqet ekrani [Network and Sharing Center] (Qendra e rrjetit dhe e ndarjes).

- 4 Zgjidhni [Customize] (Personalizo).



Shfaqet ekrani [Set Network Location] (Vendos vendndodhjen e rrjetit).

- 5 Shënoni [Private] (Private) dhe zgjidhni [Next] (Tjetër).



**6** Konfirmoni që [Location type] (Lloji i vendndodhjes) është ndryshuar në [Private] (Privat) dhe zgjidhni [Close] (Mbyll).

**7** Konfirmoni që [(Private network)] (Rrjeti privat) shfaqet në ekranin [Network and Sharing Center] (Qendra e ndarjes dhe e rrjetit) dhe mbyllni ekranin.


**8** Nëse nuk shënohet [Share my media] (Ndaje median time) në ekranin [Media Sharing] (Ndarja e medias) që shfaqet në ekranin 2, shënoni pranë [Share my media] (Ndaje median time), më pas zgjidhni [OK].



Shfaqet një listë pajisjesh që mund të lidhen.

**9** Zgjidhni [Settings...] (Cilësimet) që shfaqet pranë [Share my media to:] (Ndaje median time në:).

**10** Shënoni [Allow new devices and computers automatically] (Lejo pajisje dhe kompjuterë të rinj automatikisht) dhe zgjidhni [OK].



### Shënim


Çzgjidhni këtë element pasi të konfirmoni se sistemi mund të lidhet me kompjuterin dhe mund të luajë të dhëna audio në sistem.

## Dëgjimi i materialeve audio të ruajtura në kompjuter me Windows Vista/Windows XP

Me anë të komanduesit DLNA mund të luani një materiale audio.

# Përdorimi i transmetimit muzikor në internet (Music Services)

Mund të dëgjoni transmetime të ndryshme muzike të ofruara në internet pa përdorur një kompjuter. Për të dëgjuar transmetimin muzikor në internet, instaloni aplikacionin “Network Audio Remote” në pajisjen tuaj celulare dhe përdoreni atë si pajisje komanduese.



## Përgatitja e pajisjes celulare si komandues

Përgatitni pajisjen tuaj celulare si p.sh. telefon smartphone apo tabletë, për përdorim si pajisje komanduese.

### Shënime

- Përpara se të përdorni transmetimin muzikor në internet, kontrolloni të mëposhtmet:
  - Kontrolloni që ky sistem dhe pajisja celulare të jenë lidhur në të njëjtin rrjet.\*
  - Kontrolloni nëse sistemi është i ndezur.
  - Kontrolloni që sistemi dhe pajisja celulare të jenë lidhur me internetin.\*
  - Kontrolloni që sistemi të njihet nga kontrolluesi.
- \* Për hollësi, shihni “Si të lidhni rrjetin” (faqe 36).

- Për të përdorur Music Unlimited duhet të regjistroni sistemin.  
Për hollësi rreth regjistrimit, drejtoju në faqen vijuese të internetit (vetëm për modelet e Oqeanisë):  
<http://munlimited.com/home>

## 1 Shkarkoni aplikacionin “Network Audio Remote”.



Ju mund të shkarkoni aplikacionin falas nga “Google Play” për pajisjet Android ose “App Store” për pajisjet iPhone/iPod touch/iPad në uebsajt.

Ju mund ta kërkonte aplikacionin me lehtësi nëse shkruani “Network Audio Remote” në ekranin e kërkimit.

### Android

<https://play.google.com/store/apps/details?id=com.sony.nar.app>

### iOS

<http://itunes.apple.com/us/app/network-audio-remote/id398312883?mt=8>

### Nëse hyni me anë të kodit 2D

Lexoni 2D Code që vijon për ta hapur.

### Android



### iOS




---


## Shijimi i transmetimit muzikor në internet

### Këshillë

Ekranet e përdorura në pjesën e mëposhtme janë të pajisjes iPad. Ekranet e pajisjeve Android ose iPhone/iPod, ndryshojnë.

- 
- 1 Trokitni ose klikoni në ikonën  në ekranin e pajisjes Android ose iPhone/iPod touch/iPad.

- 
- 2 Zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B)] nga lista.



- 
- 3 Zgjidhni [Music Services] (Shërbimet Muzikore) nga [Browse Music] (Shfletu muzikën).



- 
- 4 Zgjidhni [Music Unlimited] (Muzikë pa kufi) ose [vTuner]. Shërbimet që shfaqen në listë mund të ndryshojnë në varësi të zonës. Zgjidhni [Music Unlimited] (Muzikë pa kufi) ose [vTuner].


- 
- 5 Zgjidhni materialin e dëshiruar për të luajtur dhe fillon riprodhimin.

### Këshillë

Nëse luajtja nuk fillon, kryeni sërish procesin nga hapi 1.

## Për të konfirmuar/redaktuar emrin e pajisjes

Ju mund të konfirmoni dhe redaktoni emrin e pajisjes të kësaj njësie, duke përdorur ekranin e cilësimeve Device Details (Detajet e pajisjes) në shfletues.



Emri i pajisjes

## Këshilla

- Nga kjo njësi mund të dalë tingull shumë i lartë kur vendosni e volumin shumë lart duke përdorur pajisje Android ose iPhone/iPod touch/iPad.
- Për hollësi mbi përdorimin e sistemit operativ Android ose iOS, referojuni seksionit të Ndhmës të secilit sistem operativ.
- Për hollësi mbi përdorimin e "Network Audio Remote", trokisni/klikoni mbi ikonën Help (Ndhma) ose ikonën Option (Opsioni) të saj.

# Përdorimi i AirPlay

Ju mund të luani muzikë të ruajtur në një Mac ose PC ose ato në iTunes, iPhone, iPod touch, iPad në këtë sistem duke përdorur AirPlay.

Ju mund të luani muzikë me valë pa e lidhur sistemin me një pajisje tjetër.



Kontrolli dhe transmetimi


## Modelet e përputhshme iPhone/iPod touch/iPad

iPod touch (5th generation), iPod touch (4th generation), iPod touch (3rd generation), iPhone 5, iPhone 4S, iPhone 4, iPhone 3GS, iPad (4th generation), iPad mini, iPad (3rd generation), iPad 2, iPad: iOS 4.3.3 ose version i mëvonshëm  
Mac, PC: iTunes 10.2.2 ose version i mëvonshëm


### Shënime

- Shikoni "Modelet e përputhshme iPhone/iPod touch/iPad" në këtë faqe për hollësi rreth versioneve të mbështetura të iOS ose iTunes.
- Përditësoni iOS ose iTunes në versionin më të fundit përpara se ta përdorni me këtë sistem.
- Referojuni manualit të përdorimit të pajisjes tuaj për hollësi rreth përdorimit të pajisjeve iPhone, iPod touch, iPad, iTunes ose AirPlay.

**1** Nisni aplikacionin e pajisjes suaj iPhone, iPod touch, iPad, ose iTunes.

**2** Zgjidhni ikonën  në fund djathtas të ekranit të iPhone, iPod touch ose iPad ose dritares së iTunes.

## iPhone, iPod touch ose iPad




## iTunes




**3** Zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B) XXXXXX] në menyën AirPlay të iTunes ose të iPhone, iPod touch ose iPad.

## iPhone, iPod touch ose iPad



## iTunes



---

## 4 Filloni të luani materiale audio në pajisje iPhone, iPod touch, iPad ose iTunes.

Sistemi kalon në modalitetin e funksionit AirPlay dhe luhet materiali i zgjedhur audio.

### **Për të konfirmuar/redaktuar emrin e pajisjes**

Ju mund të konfirmoni dhe redaktoni emrin e pajisjes të këtij sistemi, duke përdorur ekranin e cilësimeve në shfletues.

Për detaje shikoni ekranin Device Details (Detajet e pajisjes) në hapin 8 të "Device Details screen" (Ekranin e detajeve të pajisjes) (faqe 40).


Emri i redaktuar i pajisjes mund të rivendoset duke kryer "NW RESET" (faqe 38).

### **Këshilla**

- Nëse luajtja nuk fillon, kryeni sërish procesin nga hapi 1.
- Nga ky sistem mund të dalë tingull shumë i lartë kur vendosni e volumn shumë lart duke përdorur pajisje iPhone ose iPod touch, iPad ose iTunes.
- Për detaje mbi përdorimin e iTunes, referojuni Help (Ndihma) e iTunes.
- Niveli i volumnit të pajisjeve iPhone, iPod touch, iPad ose iTunes mund të mos jetë në gjendje të lidhet me nivelin e volumnit të këtij sistemi.
- AirPlay është i disponueshëm duke luajtur materialet audio në një iPhone/iPod touch/iPad, megjithëse nuk mund ta zgjidhni duke përdorur butonat e funksionit në njësinë e këtij sistemi.

# Përdorimi i aplikacionit “WALKMAN” në një Xperia/Xperia Tablet

Ju mund të luani muzikë të ruajtur në Xperia/Xperia Tablet në këtë sistem duke përdorur aplikacionin “WALKMAN”.




## Shënime

- Përditësoni sistemin operativ Android në versionin më të fundit përpara se ta përdorni me këtë sistem.
- Referojuni manualit të përdorimit të Xperia/Xperia Tablet për detaje.

---

**1** Nisni aplikacionin “WALKMAN” në Xperia/Xperia Tablet.


---

**2** Zgjidhni ikonën  në pjesën e sipërme të djathtë në Xperia/Xperia Tablet.

---

**3** Zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B) XXXXXX] në ekranin e shfaqur në hapin 2.

## Xperia/Xperia Tablet



---

**4** Shtypni çelësin e riprodhimit dhe filloni të luani materiale audio në Xperia/Xperia Tablet.


Sistemi kalon në modalitetin e funksionit të rrjetit dhe luhet materiali i zgjedhur audio.

## Këshilla

- Nëse luajtja nuk fillon, kryeni sërish procedurën nga hapi 1.
- Për hollësi për përdorimin e sistemit operativ Android, referojuni Help (Ndihmës) së sistemit operativ Android.
- Funksioni i rrjetit është i disponueshëm duke luajtur materialet audio në një Xperia/Xperia Tablet, megjithëse nuk mund ta zgjidhni duke përdorur butonat e funksionit në njësinë e këtij sistemi.
- Ky sistem mund të luajë muzikën e ruajtur në disa modele “WALKMAN” duke përdorur funksionin Music Throw. Për detaje mbi funksionin Music Throw, referojuni manualit të përdorimit të dhënë me pajisjen tuaj “WALKMAN”.



# Dëgjimi i radios



## Sintonizimi te një stacion radioje

**1** Shtypni TUNER FUNCTION **[4]** për të zgjedhur një brez radioje. Shtypni FUNCTION **[4]** në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "TUNER FM" ose "TUNER AM" të shfaqet (CMT-SBT300W), ose "DAB" ose "TUNER FM" të shfaqet (CMT-SBT300WB) në ekranin **[10]**.

**2** Shtypni TUNING MODE **[21]** në mënyrë të përsëritur derisa "AUTO" të shfaqet në ekranin **[10]**. Sa herë që shtypni këtë buton, modaliteti i sintonizimit ndryshon në AUTO, PRESET ose MANUAL.

**3** Shtypni TUNE +/- **[8]**. Treguesi i frekuencës në ekranin **[10]** fillon të ndryshojë.

Sintonizimi ndalon automatikisht kur sintonizohet në një stacion radioje dhe në ekranin Automatic Scanning (Skanim automatik) shfaqet "STEREO" (kur merret transmetim stereo FM).



### Sintonizimi manual


Shtypni TUNING MODE **[21]** në mënyrë të përsëritur derisa në ekran shfaqet "MANUAL" **[10]**, më pas shtypni TUNE +/- **[8]** për t'u sintonizuar në stacionin e dëshiruar.

### Shënime mbi stacionet DAB/DAB+ (vetëm CMT-SBT300WB)

- Kur sintonizoheni në një stacion që ofron shërbime RDS, transmetuesit japin informacione të tilla si emrin e shërbimit ose emrin e stacionit.
- Kur sintonizoheni në një stacion DAB/DAB+, mund të duhen disa sekonda para se të dëgjoni një zë.
- Shërbimi parësor merret automatikisht kur mbyllet shërbimi dytësor.
- Ky sintonizues nuk mbështet shërbimet e të dhënave.

## Këshillë

Nëse marrja në një transmetim stereo FM është me zhurmë, shtypni FM MODE [22] në mënyrë të përsëritur derisa "MONO" të shfaqet në ekran për të zgjedhur marrjen mono. Kjo redukton zhurmën.



"MONO" shfaqet për katër sekonda.

## Për të ndryshuar intervalin e sintonizimit AM (përveç modeleve të Evropës)

Cilësimi i paracaktuar për intervalin e sintonizimit AM është 9 kHz (ose 10 kHz për disa zona). Përdorni butonat në njësi për të kryer këtë veprim.


- 1 Shtypni FUNCTION [4] në njësi në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur stacionin AM.
- 2 Shtypni I/⏻ (energjia) [1] për të fikur sistemin.
- 3 Mbani shtypur FUNCTION [4] dhe shtypni I/⏻ (energjia) [1] në njësi. "STEP 9K" ose "STEP 10K" shfaqet në ekranin [10]. Kur ndryshoni intervalin, të gjitha stacionet e paravendosura AM do të fshihen.

## Paravendosja e stacioneve të radios

Ju mund të paravendosni stacionet e preferuara të radios.

- 1 Sintonizohuni në stacionin që dëshironi të paravendosni.
- 2 Shtypni TUNER MEMORY [23].

Numri i paravendosjes



- 3 Shtypni TUNE +/- [8] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur një numër të paravendosur.

Nëse është caktuar një stacion tjetër në numrin e paravendosur të zgjedhur, stacioni zëvendësohet me stacionin e ri.

- 4 Shtypni ⊕ [33] për të regjistruar stacionin.

"COMPLETE" shfaqet në ekranin [10].

- 5 Përsëritni hapat 1 deri 4 për të regjistruar stacionet e tjera.

Ju mund të paravendosni deri në 20 stacione FM dhe 10 stacione AM (CMT-SBT300W) ose 20 stacione DAB/DAB+ dhe 20 stacione FM (CMT-SBT300WB).

## Për t'u sintonizuar te një stacion radioje i paravendosur

Shtypni TUNING MODE [21] në mënyrë të përsëritur derisa "PRESET" të shfaqet në ekranin [10] dhe më pas shtypni TUNE +/- [8] për të zgjedhur numrin e paravendosur tek i cili është regjistruar stacioni i dëshiruar.

## Ekzekutimi i skanimit automatik DAB në mënyrë manuale (vetëm CMT-SBT300WB)

Para se të mund të sintonizoheni në stacionet DAB/DAB+, duhet të kryeni një skanim fillestar të DAB.

Kur të keni lëvizur në një zonë tjetër, kryeni po ashtu skanimin fillestar të DAB për të përditësuar manualisht informacionin e shërbimit DAB/DAB+.

**1** Shtypni TUNER FUNCTION [4] në mënyrë të përsëritur derisa "DAB" të shfaqet në ekranin [10].

Shtypni FUNCTION [4] në njësi në mënyrë të përsëritur derisa "DAB" të shfaqet në ekranin [10].

**2** Shtypni OPTIONS [34] për të shfaqur menyne e cilësimeve.

**3** Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "INITIAL", më pas shtypni ⊕ [33].


**4** Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "OK", më pas shtypni ⊕ [33].

Fillon skanimi. Progresi i skanimit tregohet nga yjet (\*\*\*\*\*). Në varësi të shërbimeve DAB/DAB+ të disponueshme në zonën tuaj, skanimi mund të zgjasë disa minuta. Kur përfundon skanimi, krijohet një listë e shërbimeve të disponueshme.

#### Shënime

- Nëse vendi ose rajoni juaj nuk e mbështet transmetimin DAB/DAB+, shfaqet "NO SERV".
- Kjo procedurë pastron të gjitha paravendosjet e ruajtura më parë.
- Para se të shkëputni antenën prej plumbi DAB/FM, sigurohuni që sistemi të jetë i fikur për të ruajtur cilësimet tuaja të DAB/DAB+.

# Përdorimi i komponentëve opsionalë audio



- 
- 1** Shtypni VOLUME – [17] në telekomandë për të ulur volumin. Rrotulloni çelësin VOLUME [17] në njësi në drejtim të kundërt të akrepave të orës për të ulur volumin.

- 
- 2** Lidhni komponentin shtesë audio me folenë AUDIO IN [C] (faqe 13). Lidhni pajisjen e jashtme opsionale me një kabllo të lidhjes audio (nuk është e përfshirë).

- 
- 3** Shtypni AUDIO IN FUNCTION [4]. Shtypni FUNCTION [4] në njësi në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet "AUDIO IN" në ekranin [10].

- 
- 4** Nisni riprodhimin e komponentit të lidhur dhe rregulloni volumin. Rregulloni volumin në komponentin e lidhur gjatë riprodhimit.

- 
- 5** Shtypni VOLUME +/- [17] në telekomandë për të rregulluar volumin. Rrotulloni çelësin VOLUME [17] në njësi majtas ose djathtas për të rregulluar volumin.

## Shënim

Sistemi mund të kalojë automatikisht në modalitet Standby (Gatishmërie) nëse niveli i volumit të komponentit të lidhur është tepër i ulët. Rregulloni përkatësisht volumin e komponentit. Shikoni "Vendosja e funksionit të Automatic Standby (Gatishmërisë automatike)" (faqe 61).

# Vendosja e funksionit të gatishmërisë automatike

Ky sistem është pajisur me një funksion të gatishmërisë automatike. Me këtë funksion, sistemi kalon automatikisht në modalitetin e gatishmërisë pas 15 minutash kur nuk përdoret ose nuk ka dalje sinjali audio. "AUTO STBY" shfaqet në ekranin [10] për 2 minuta përpara se sistemi të hyjë në modalitetin e gatishmërisë.

Si parazgjedhje, funksioni i gatishmërisë automatike është i aktivizuar. Këtë funksion mund ta çaktivizoni me anë të menysë së opsioneve.

---

**1** Shtypni **OPTIONS** [34] për të shfaqur menynë e cilësimeve.

---

**2** Shtypni **▲/▼** [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "AUTO STBY", më pas shtypni **+** [33].

---

**3** Shtypni **▲/▼** [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "ON" ose "OFF", më pas shtypni **+** [33].

## Shënime

- Funksioni i gatishmërisë automatike është i pavlefshëm për funksionin e sintonizuesit (FM/AM/DAB\*) edhe kur e keni aktivizuar.
  - Sistemi mund të mos kalojë automatikisht në modalitetin e gatishmërisë në rastet e mëposhtme:
    - ndërkohë që po diktohet një sinjal audio
    - gjatë riprodhimit të pjesëve audio ose skedarëve
    - ndërkohë që është në proces kohëmatësi i paravendosur i fjetjes ose kohëmatësi me luajtje
  - Sistemi numëron mbrapsht kohën (15 minuta) sërish derisa kalon në modalitetin e gatishmërisë, edhe kur funksioni i gatishmërisë automatike është aktivizuar në rastet e mëposhtme:
    - kur është lidhur një pajisje USB.
    - kur është shtypur një buton në telekomandë ose njësi
- \* AM disponohet vetëm për CMT-SBT300W ose DAB është vetëm për CMT-SBT300WB.

# Vendosja e modalitetin BLUETOOTH/ gatishmërisë automatike

Ju mund të aktivizoni/çaktivizoni modalitetin e BLUETOOTH/gatishmërisë së rrjetit. Kur aktivizohet modaliteti i gatishmërisë së BLUETOOTH/gatishmërisë së rrjetit, sistemi kalon në modalitetin e pritjes për BLUETOOTH ose lidhjen e rrjetit edhe kur sistemi është i fikur. Modaliteti i gatishmërisë së BLUETOOTH/gatishmërisë së rrjetit çaktivizohet si parazgjedhje.

---

**1** Shtypni **OPTIONS** **[34]** për të shfaqur menynë e cilësimeve.

---

**2** Shtypni **▲/▼** **[24]** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "BT/NW STBY", më pas shtypni **+** **[33]**.

---

**3** Shtypni **▲/▼** **[24]** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "ON" ose "OFF", më pas shtypni **+** **[33]**.

---

**4** Shtypni **I/⏻** (energjia) **[1]** për të fikur sistemin.

Kur "BT/NW STBY" është i caktuar si "ON", sistemi aktivizohet dhe mund të dëgjon muzikë duke aktivizuar BLUETOOTH ose AirPlay në komponentin e lidhur.

## Shënim

Riprodhimi në pajisje DLNA ose duke përdorur Music Services nuk është i mundur.

# Përditësimi i softuerit

Ju mund ta përditësoni softuerin e këtij sistemi duke shkarkuar versionin më të fundit përmes një rrjeti. Nëse sistemi dallon një përditësim të ri kur lidhet me internetin, shfaqet "UPDATE" në ekranin [10]. Këtë softuer mund ta përditësoni me anë të menysë së opsioneve.




- 1 Shtypni OPTIONS [34] për të shfaqur menynë e cilësimeve.
- 2 Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "UPDATE", më pas shtypni ⊕ [33].
- 3 Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "OK", më pas shtypni ⊕ [33].  
Fillon përditësimi.

## Shënime

- Zakonisht mund të duhen rreth 3 deri 10 minuta që sistemi të përfundojë përditësimin. Mund të nevojitet më shumë kohë në varësi të ambientit të rrjetit.
- Mos e përdorni njësinë apo telekomandën gjatë përditësimit. Gjithashtu, mos e fikni sistemin ose mos e shkëputni kordonin e rrymës gjatë përditësimit.

# Rregullimi i tingullit

Ju mund të vendosni përforcimin e basit ose të rregulloni tonin sipas preferencave.



## Vendosja e përforcimit të basit

Shtypni BASS BOOST **16** në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "ON" ose "OFF".

## Rregullimi i basit dhe sopranos

Shtypni BASS +/- **29** për të rregulluar basin ose TREBLE +/- **30** për të rregulluar sopranon.


- Në njësi, shtypni EQ **14** në njësi në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "BASS" ose "TREBLE" dhe rregulloni artikullin e zgjedhur duke përdorur TUNE +/- **8**.

## Këshillë

Ky sistem është i pajisur me funksionin DSEE për të riprodhuar një zë soprano të qartë pavarësisht uljes së cilësisë të shkaktuar nga ngjeshja. Funksioni DSEE zakonisht aktivizohet automatikisht duke njohur burimin e zërit, por mund të mos aktivizohet në varësi të funksionit në përdorim.



# Ndryshimi i afishimit



Për	Veproni si më poshtë:
Shikimin e informacionit në ekranin <b>10</b> <sup>*1</sup>	Shtypni DISPLAY <b>28</b> në mënyrë të përsëritur kur sistemi është i ndezur.
Shfaqjen e orës	Shtypni DISPLAY <b>28</b> në mënyrë të përsëritur kur sistemi është i fikur. <sup>*2</sup> Ora shfaqet për rreth 8 sekonda.

\*1 Ju mund të shihni informacionin e përshkruar më poshtë gjatë luajtjes së një disku CD-DA/MP3.

\*2 Informacioni nuk shfaqet në modalitetin BLUETOOTH/gatishmërinë e rrjetit.

## Disk CD-DA

- koha e mbetur e luajtjes së një pjese gjatë riprodhimit
- koha totale e mbetur e luajtjes

## Disk MP3 MP3

- emri i pjesës ose i skedarit
- emri i artistit
- emri i albumit

## Shënime për informacionin e afishimit

- Karakteret që nuk mund të shfaqen duken si “\_”.
- Nuk shfaqen të mëposhtmet:
  - koha e luajtjes ose koha totale e luajtjes e mbetur për një disk MP3
  - koha e mbetur e luajtjes për një skedar MP3
- Nuk shfaqen saktë të mëposhtmet:
  - koha e kaluar e luajtjes e një skedari MP3 të koduar duke përdorur VBR (Shpejtësi të ndryshueshme bitesh)
  - emrat e dosjeve dhe skedarëve që nuk ndjekin ISO9660 Niveli 1/ Niveli 2, ose Joliet në formatin e zgjerimit

- Shfaqen të mëposhtmet:
  - koha totale e luajtjes për një disk CD-DA (përveçse kur zgjidhet modaliteti PGM dhe luajtësi ndalohet)
  - koha e mbetur e luajtjes për një pjesë të një disku CD-DA
  - koha e mbetur e luajtjes për një disk CD-DA (vetëm kur zgjidhet modaliteti i luajtjes normale gjatë riprodhimit)
  - Informacioni i etiketës ID3 për skedarët MP3. Shfaqja e informacionit të etiketës së ID3 versioni 2 ka prioritet kur përdoren etiketat e ID3 versioni 1 dhe versioni 2 për një skedar të vetëm MP3
  - deri në 64 karaktere për një etiketë të ID3, ku karakteret e lejuara janë shkronjat e mëdha (A deri në Z), numrat (0 deri në 9) dhe simbolet (\* \$ % ' ( ) \* + , - . / < = > @ [ \ ] \_ ` { | } ! ? ^ ~)

## Shënime mbi informacionin e luajtjes së DAB/DAB+ (vetëm CMT-SBT300WB)

Shfaqen po ashtu të mëposhtmet;

- deri në 8 karaktere të emrit të shërbimit, deri në 128 karaktere të DLS (Segmenti i etiketës dinamike) dhe deri në 16 karaktere të etiketës së bashkuar.
- do të shfaqet një vlerë ndërmjet 0 dhe 100 si treguese e cilësisë së sinjalit.

# Përdorimi i kohëmatësve


Sistemi ofron Sleep Timer (Kohëmatësin e fjetjes) dhe Play Timer (Kohëmatësin e luajtjes).

Kohëmatësi i fjetjes ka prioritet ndaj kohëmatësit të luajtjes.

Ju mund ta caktoni kohëmatësin me anë të butonave në telekomandë.

## Caktimi i kohëmatësit të fjetjes

Sistemi fiket automatikisht pasi të kalojë koha e caktuar për Sleep Timer (Kohëmatësin e fjetjes). Sleep Timer (Kohëmatësi i fjetjes) funksionon edhe nëse ora nuk është vendosur.




**1** Shtypni SLEEP **[20]** në mënyrë të përsëritur për të specifikuar kohën.

- Zgjidhni "30MIN" për ta fikur sistemin pas 30 minutash.
- Për të anuluar Kohëmatësin e fjetjes zgjidhni "OFF".

## Vendosja e Play Timer (Kohëmatësit të luajtjes).

Ju mund të dëgjoni një disk CD-DA ose MP3 ose radion çdo ditë në një orë të paravendosur.

Sigurohuni që të keni vendosur orën para se të vendosni kohëmatësin.



**1** Përgatitni burimin e tingullit.

- Përgatitni burimin e tingullit dhe rrotulloni çelësin VOLUME **[17]** në njësi majtas ose djathtas ose shtypni VOLUME +/- **[17]** në telekomandë për të rregulluar volumnin. Burimet e disponueshme të zërit janë: CD, USB, dhe TUNER (FM, AM ose DAB)\*<sup>1</sup> FUNCTION
- Për të luajtur pjesët ose skedarët e dëshiruar vetëm në disk, krijoni një program. Shikoni "Krijimi i programit individual (Luajtja e programit)" (faqe 22).

- Për të dëgjuar një program radioje, sintonizohuni në stacionin e dëshiruar, duke përdorur Automatic Scanning (Skanimi automatik), Manual Tuning (Sintonizimi manual) ose Preset Tuning (Sintonizimi i paravendosur) (faqe 57).

\*1 FM ose AM për CMT-SBT300W, ose FM ose DAB për CMT-SBT300WB.

## 2 Shtypni TIMER MENU [19].

## 3 Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PLAY SET", më pas shtypni ⊕ [33]. Ora e nisjes pulson në ekranin [10].

## 4 Vendosni kohën e fillimit të veprimit.

Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të vendosur orën, më pas shtypni ⊕ [33]. Treguesi i minutave pulson. Përdorni procedurën e mësipërme për të vendosur minutat. Kur të keni vendosur kohën e nisjes, sistemi kalon te cilësimi i kohës së ndalimit.

## 5 Përdorni të njëjtën procedurë si në hapin 4 për të vendosur kohën e ndalimit të veprimit.

### Nëse "TIME NG" pulson në ekran

Koha e fillimit dhe koha e përfundimit janë vendosur në të njëjtën kohë. Ndryshoni kohën e ndalimit.

## 6 Zgjidhni burimin e tingullit.

Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet burimi i dëshiruar i tingullit, më pas shtypni ⊕ [33]. Burimet e disponueshme të zërit janë: CD, USB dhe TUNER (FM, AM ose DAB)\*<sup>1</sup> FUNCTION.

\*1 FM ose AM për CMT-SBT300W, ose FM ose DAB për CMT-SBT300WB.

Pasi të përfundojë zgjedhja e burimit të zërit, shfaqet ekрани i konfirmimit për Play Timer (Kohëmatësin e luajtjes).

## 7 Shtypni I/⏻ (energjia) [1] për të fikur sistemin.

- Kur kohëmatësi i luajtjes është i vendosur, sistemi ndizet automatikisht pas rreth 15 sekondash (për FM, AM ose DAB\*) ose rreth 90 sekondash (për një disk CD-DA ose pajisje USB) para kohës së paravendosur.
- Kohëmatësi i luajtjes nuk funksionon nëse sistemi ndizet në kohën e paravendosur. Kini kujdes që të mos e përdorni sistemin deri sa të ndizet dhe të fillojë luajtjen me kohëmatësin.

\* AM disponohet vetëm për CMT-SBT300W ose DAB është vetëm për CMT-SBT300WB.

## Për të kontrolluar cilësimin

- 1 Shtypni TIMER MENU [19].
- 2 Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "SELECT" dhe më pas shtypni ⊕ [33].
- 3 Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "PLAY SEL" dhe më pas shtypni ⊕ [33].  
Cilësimi i kohëmatësit shfaqet në ekranin [10].

## Për të anuluar kohëmatësin

- 1 Shtypni TIMER MENU [19].
- 2 Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "SELECT" dhe më pas shtypni ⊕ [33].
- 3 Shtypni ▲/▼ [24] në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "OFF" dhe më pas shtypni ⊕ [33].

## **Për të ndryshuar cilësimin**

Kryeni të njëjtat procedura për të ndryshuar cilësimin e Play Timer (Kohëmatësit të luajtjes).

### **Shënime**

- Kur burimi i tingullit për një kohëmatës të luajtjes vendoset në një stacion radioje që e vendosni duke përdorur Automatic Scanning (Skanimin automatik) (AUTO) ose Manual Tuning (Sintonizimin manual) (MANUAL) dhe ndryshoni frekuencën ose bandën e radios pasi vendosni kohëmatësin, edhe cilësimi i stacionit të radios për kohëmatësin do të ndryshojë po ashtu.
- Kur burimi i tingullit për një kohëmatës të luajtjes vendoset në një stacion radioje të sintonizuar nga një stacion radioje i paravendosur (numri i paravendosur 1 deri në 20), nëse ndryshoni frekuencën e stacionit të radios ose bandën pasi vendosni kohëmatësin, cilësimi i stacionit të radios për kohëmatësin nuk do të ndryshojë. Sintonizimi i stacionit të radios për kohëmatësin është i fiksuar në atë që keni caktuar.

### **Këshillë**

Cilësimi i Play Timer (Kohëmatësit të luajtjes) mbetet për sa kohë që cilësimi nuk anulohet manualisht.

# Zgjidhja e problemeve

Nëse ndodh një problem gjatë përdorimit të sistemit, ndiqni hapat e përshkruar më poshtë përpara se të konsultoheni me shitësin më të afërt të Sony. Nëse shfaqet një mesazh gabimi, sigurohuni që të bëni shënime të përmbajtjes së gabimit për referencë.

1 Kontrolloni për të parë nëse problemi është renditur në këtë pjesë të "Zgjidhja e problemeve".

2 Kontrolloni uebsajtet e mëposhtme të mbështetjes së klientëve.

Për klientët në Evropë:

<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në vende/rajone të tjera:

<http://www.sony-asia.com/support>

Do të gjeni informacionin më të fundit të mbështetjes dhe një listë të PESH në këto uebsajte.

3 Nëse, pas hapit 1 dhe 2, vazhdoni të mos e zgjidhni problemin, këshillohuni me shitësin më të afërt të Sony.

Nëse problemi vazhdon pasi të kryeni të gjitha sa më sipër, këshillohuni me shitësin më të afërt të Sony.

Kur të sillni produktin për riparim, sigurohuni që të keni sjellë të gjithë sistemin (njësinë kryesore dhe telekomandën).

Ky produkt është produkt sistem, dhe nevojitet i gjithë sistemi për të përcaktuar pjesën që kërkon riparim.

## Nëse treguesi STANDBY [2] pulson

Hiqeni menjëherë nga prizë kordonin elektrik dhe kontrolloni elementin e mëposhtëm:

- A ka pësuar kordoni i altoparlantit qark të shkurtër?

Pasi treguesi STANDBY [2] të ndalojë së pulsuar, rilidhni sërish kordonin elektrik dhe ndizni sistemin. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.

## Të përgjithshme

Sistemi nuk ndizet.

- A është vendosur siç duhet në një prizë kordoni elektrik?

Sistemi ka kaluar papritur në modalitetin Standby (Gatishmërisë).

- Ky nuk është defekt. Sistemi kalon automatikisht në modalitetin e Standby (Gatishmërisë) pas 15 minutash kur nuk përdoret ose nuk ka dalje sinjali audio. Shikoni "Vendosja e funksionit të Automatic Standby (Gatishmërisë automatike)" (faqe 61).

Cilësimi i orës ose funksionimi i Play Timer (Kohëmatësit të luajtjes) është anuluar papritur.

- Nëse kalon rreth një minutë pa përdorim, cilësimi i orës ose cilësimi i kohëmatësit me luajtje anulohen automatikisht. Kryeni veprimin sërish nga fillimi.

---

## Nuk ka tingull.

---

- ➔ Sigurohuni se kordonët e altoparlantëve janë lidhur si duhet.
- ➔ Kontrolloni se po përdoren altoparlantët e dhënë.
- ➔ Rrotulloni çelësin VOLUME [17] në njësi në drejtim të akrepave të orës ose shtypni VOLUME + [17] në telekomandë për të ngritur volumnin.
- ➔ Sigurohuni që kufjet të jenë të shkëputura nga foleja e kufjeve.
- ➔ Sigurohuni që një komponent i jashtëm është i lidhur mirë me folenë AUDIO IN [C] dhe vendoseni funksionin në AUDIO IN.
- ➔ Stacioni i specifikuar mund të ketë ndaluar papritur transmetimin.
- ➔ Ekuilibri i zërit majtas dhe djathtas është i gabuar. Kontrolloni që altoparlantët majtas dhe djathtas të jenë lidhur saktë.
- ➔ Vendosni altoparlantët në mënyrë simetrike.
- ➔ Lidhni altoparlantët e dhënë.

---

## Ndodh gumëzhitje ose zhurmë e madhe.

---

- ➔ Lëvizeni sistemin larg burimeve të zhurmës.
- ➔ Lidhni sistemin në një prizë tjetër muri.
- ➔ Rekomandohet përdorimi i një burimi të energjisë së alternuar me një filtër zhurme (nuk është i përfshirë).

---

## Telekomanda nuk funksionon.

---

- ➔ Hiqni çdo pengesë mes telekomandës dhe sensorit të telekomandës në njësi dhe pozicionojeni njësinë larg dritave fluoreshente.
- ➔ Drejtojeni telekomandën drejt sensorit të telekomandës në njësi.
- ➔ Lëvizeni telekomandën më pranë sistemit.

---

## Disk CD-DA/MP3

---

“LOCKED” shfaqet në ekranin [10] dhe disku nuk mund të nxirret.

- ➔ Këshillohuni me shitësin më të afërt Sony ose pikën lokale të autorizuar të shërbimit Sony.

---

## Disku ose skedari nuk luhet.

---

- ➔ Disku nuk është finalizuar (një disk CD-R ose CD-RW ku mund të shtohen të dhëna).

---

## Tingulli kapërcehet ose disku nuk luhet.

---

- ➔ Fshijeni diskun dhe vendoseni përsëri.
- ➔ Zhvendoseni sistemin në një vend larg dridhjeve (për shembull, mbi një mbështetëse të qëndrueshme).
- ➔ Oshilacioni i altoparlantëve mund të shkaktohet nga luhatjet e zërit, në varësi të nivelit të volumnit. Largoni altoparlantët nga njësia ose ndryshoni vendndodhjen e altoparlantëve.

---

## Luajtja nuk fillon nga pjesa e parë ose skedari i parë.

---

- ➔ Rikthehuni te luajtja normale duke shtypur PLAY MODE [27] në mënyrë të përsëritur në modalitetin e ndalimit derisa të zhduken “PGM” dhe “SHUF” në ekranin [10].

---

## Nisja e riprodhimit kërkon më shumë kohë se zakonisht.

---

- ➔ Disqet e mëposhtme mund të rrisin kohën që duhet për të nisur riprodhimin:
  - një disk i regjistruar me një strukturë të komplikuar peme
  - një disk i regjistruar në formatin me shumë sesione
  - një disk që ka shumë dosje

## iPod/iPhone/iPad

### Nuk ka tingull.

- ➔ Sigurohuni që pajisja iPod/iPhone/iPad të jetë lidhur mirë me portën USB **18**.
- ➔ Ndaloni riprodhimin dhe lidhni iPod/iPhone/iPad me sistemin.
- ➔ Sigurohuni që iPod/iPhone/iPad të jetë përditësuar me softuerin më të fundit. Nëse jo, përditësojeni iPod/iPhone/iPad përpara se ta përdorni me sistemin.
- ➔ Rrotulloni çelësin VOLUME **17** në njësi në drejtim të akrepave të orës ose shtypni VOLUME + **17** në telekomandë për të ngritur volumnin.
- ➔ Pajisja iPod/iPhone/iPad mund të mos mbështetet nga ky sistem. Shihni "Modelet e përputhshme iPod/iPhone/iPad" (faqe 24).

### Zëri është i shtrembëruar.

- ➔ Sigurohuni që pajisja iPod/iPhone/iPad të jetë lidhur mirë me portën USB **18**.
- ➔ Rrotulloni çelësin VOLUME **17** në njësi në drejtim të akrepave të orës ose shtypni VOLUME + **17** në telekomandë për të ngritur volumnin.
- ➔ Vendoseni cilësimin e "EQ" të iPod/iPhone/iPad në "Off" ose "Flat".
- ➔ Pajisja iPod/iPhone/iPad mund të mos mbështetet nga ky sistem. Shikoni "Modelet e përputhshme iPod/iPhone/iPad" (faqe 24).

### iPod/iPhone/iPad nuk funksionon.

- ➔ Fikni çdo aplikacion tjetër iOS që është në ekzekutim në iPod/iPhone/iPad. Për detaje, referojuni manualit të përdorimit të dhënë me iPod/iPhone/iPad.
- ➔ Sigurohuni që pajisja iPod/iPhone/iPad të jetë lidhur mirë me portën USB **18**.
- ➔ Sigurohuni që iPod/iPhone/iPad të jetë përditësuar me softuerin më të fundit. Nëse jo, përditësojeni iPod/iPhone/iPad përpara se ta përdorni me sistemin.
- ➔ Duke qenë se përdorimi i sistemit dhe iPod/iPhone/iPad janë të ndryshëm, ju nuk mund të përdorni iPod/iPhone/iPad duke përdorur butonat në telekomandë ose njësi. Në këtë rast, përdorni butonat e kontrollit në iPod/iPhone/iPad.

### iPod/iPhone/iPad nuk mund të karikohet.

- ➔ Sigurohuni që iPod/iPhone/iPad të jetë lidhur mirë me portën USB **18** përmes kablos së dhënë me iPod/iPhone/iPad.
- ➔ iPod/iPhone/iPad nuk mund të karikohet kur sistemi është i fikur.

## Pajisje USB

### Është lidhur një disk ose pajisje USB e pambështetur.

- ➔ Nëse lidhni një pajisje të pambështetur USB, mund të ndodhin problemet e mëposhtme. Kontrolloni informacionin në faqet e internetit rreth pajisjeve USB të pajtueshme me URL-të e listuara në "Luajtja e një skedari në një pajisje USB" (faqe 26).
  - Pajisja USB nuk njihet.
  - Emrat e skedarëve ose të dosjeve nuk shfaqen në këtë sistem.
  - Riprodhimi nuk është i mundur.
  - Tingulli kapërcehet.
  - Ka zhurmë.
  - Tingulli del i shtrembëruar.

### Nuk ka tingull.

- ➔ Pajisja USB nuk është lidhur saktë. Fikni sistemin dhe më pas rilidhni pajisjen USB.

### Ka zhurmë, tingulli kapërcehet ose është i shtrembëruar.

- ➔ Është lidhur një disk ose pajisje USB e pambështetur. Lidhni një pajisje USB që mbështetet.
- ➔ Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, dhe më pas ndizni sistemin.
- ➔ Vetë të dhënat muzikore përmbajnë zhurmë, ose tingulli është i distortuar. Zhurma mund të jetë futur gjatë krijimit të të dhënave muzikore për shkak të gjendjes së kompjuterit. Në një rast të tillë, fshini skedarin dhe dërgoni përsëri të dhënat e muzikës.
- ➔ Shpejtësia në bit e përdorur gjatë kodimit të skedarëve ishte e ulët. Dërgoni te pajisja USB skedarët e koduar me shpejtësi në bit më të larta.

---

“READING” shfaqet për një periudhë të gjatë kohe ose duhet shumë përpara se të fillojë riprodhimi.

---

- ➔ Procesi i leximit mund të kërkojë një kohë të gjatë në rastet e mëposhtme.
    - Ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB.
    - Kur struktura e skedarëve është jashtëzakonisht e ndërlikuar.
    - Nuk ka hapësirë të lirë të mjaftueshme në memorie.
    - Kur memoria e brendshme është e fragmentuar.
- 

Emri i skedarit ose dosjes (emri i albumit) nuk shfaqet saktë.

---

- ➔ Dërgoni përsëri të pajisja USB të dhënat muzikore, pasi të dhënat e ruajtura në pajisjen USB mund të jenë të dëmtuara.
  - ➔ Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky sistem janë si më poshtë:
    - Shkronjat e mëdha (A deri në Z).
    - Numrat (0 deri në 9).
    - Simbolet (< > \* +, [ ] @ \ \_).Karakteret e tjera shfaqen si “\_”
- 

Pajisja USB nuk njihet.

---

- ➔ Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizni sistemin.
  - ➔ Kontrolloni informacionin në faqet e internetit rreth pajisjeve USB të pajtueshme me URL-të e listuara në “Luajtja e një skedari në një pajisje USB” (faqe 26).
  - ➔ Pajisja USB nuk punon si duhet. Referojuni manualit të përdorimit që shoqëron pajisjen USB mbi mënyrën e trajtimit të këtij problemi.
- 

Luajtja nuk fillon.

---

- ➔ Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizni sistemin.
  - ➔ Kontrolloni informacionin në faqet e internetit rreth pajisjeve USB të pajtueshme me URL-të e listuara në “Luajtja e një skedari në një pajisje USB” (faqe 26).
- 

Luajtja nuk fillon nga pjesa e parë.

---

- ➔ Vendosni modalitetin e luajtjes në modalitetin Normal Play (Luajtja normale).
- 

---

Pajisja USB nuk mund të karikohet.

---

- ➔ Sigurohuni që pajisja USB të jetë lidhur mirë.
  - ➔ Ngarkimi nuk mund të kryhet kur sistemi është i fikur.
  - ➔ Pajisja USB mund të mos mbështetet nga ky sistem. Kontrolloni informacionin në uebsajte mbi pajtueshmërinë e pajisjeve USB.
- 

## Sintonizuesi

---

Gumëzhitje ose zhurmë të madhe ndodh (“STEREO” vezullon në dritaren e ekranit **[10]**), ose transmetimet nuk mund të merren.

---

- ➔ Lidhni antenën mirë.
  - ➔ Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhe më pas vendosni antenën sërish.
  - ➔ Mbajeni antenat larg nga njësia, kordoni i altoparantit ose komponentët e tjerë për të shmangur kapjen e zhurmës.
  - ➔ Fikni pajisjet elektrike aty pranë.
- 

Dëgjojen disa stacione radioje në të njëjtën kohë.

---

- ➔ Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhe më pas vendosni antenën sërish.
  - ➔ Bashkoni kabllo të antenave duke përdorur kapëse kordonësh që qarkullojnë në treg, për shembull, dhe rregulloni gjatësitë e kabllove.
- 

Stacioni i radios DAB/DAB+ nuk merret si duhet.

---

- ➔ Kontrolloni të gjitha lidhjet e antenave, më pas procedurën e DAB Automatic Scan (Skanimit automatik DAB). Shihni “Ekzekutimi i skanimit automatik DAB në mënyrë manuale (vetëm CMT-SBT300WB)” (faqe 58).
  - ➔ Shërbimi aktual DAB/DAB+ mund të mos jetë i disponueshëm.

Shtypni TUNE +/- **[8]** për të zgjedhur një shërbim tjetër.
  - ➔ Nëse keni lëvizur në një zonë tjetër, disa shërbime/frekuenca mund të kenë ndryshuar dhe mund të mos arrini të sintonizoheni në transmetimin tuaj të zakonshëm. Kryeni procedurën e skanimit automatik DAB për të regjistruar përsëri përmbajtjet e transmetimeve. (Kryerja e kësaj procedure pastron të gjitha paravendosjet e ruajtura më parë.)
-



---

## Transmetimi DAB/DAB+ është ndërprerë.

---


- ➔ Kontrolloni vendndodhjen e sistemit ose rregulloni orientimin e antenës për të rritur vlerën e treguar të cilësisë së sinjalit.

## Lidhja me rrjetin

---

### Sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin. (Pajisjet e tjera në rrjet nuk arrijnë të gjejnë ose njohin sistemin).

---

- ➔ Kontrolloni që  të jetë nderur në ekran **10**.
- ➔ Duhet rreth 1 minutë që sistemi të marrë një adresë IP kur sistemi ndizet në një mjedis komunikimi pa ruter.
- ➔ Kur përdorni një adresë fikse IP, e njëjta adresë IP mund të përdoret nga një pajisje tjetër. Përdorni një adresë tjetër IP.

### Sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin përmes një lidhjeje LAN me valë.

---

- ➔ Nëse një kablo rrjeti (LAN) lidhet me sistemin, sistemi automatikisht vihet në punë për të krijuar një lidhje LAN me kablo. Nëse dëshironi të përdorni një lidhje LAN me valë, mos lidhni kablo rrjeti (LAN) me sistemin.
- ➔ Kontrolloni konfigurimin e ruterit LAN me valë/pikës së aksesit. Nëse SSID Stealth Mode (Modaliteti i fshehtë SSID) është vendosur në ON (Ndezur) në pikën e aksesit, vendoseni në OFF (Fikur). Për hollësi rreth cilësimeve të pikës së aksesit, drejtoju manualit të përdorimit për pikën e aksesit.

### Sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin duke përdorur WPS.

---

- ➔ Konfiguroni rrjetin pasi të kërkonti pikën e aksesit duke përdorur skanimin e pikës së aksesit.

### Shpejtësia e komunikimit të lidhjes LAN me valë është ulur papritur.

---


- ➔ Shpejtësia e komunikimit të LAN-it me valë ulet për ruterët LAN me valë/ pikat e aksesit, të përputhshme me IEEE802.11n nëse metoda e sigurisë vendoset në WEP ose WPA/WPA2-PSK (TKIP). Skema e enkriptimit (siguria) varion në varësi të pajisjes. Për detaje, referoju manualit të përdorimit të ruterit tuaj/pikës së aksesit.

## Music Services

---

### Sistemi nuk mund të lidhet me Music Services.

---

- ➔ Sigurohuni që ruteri LAN me valë/pikë aksesi të jetë nderur.
- ➔ Kontrolloni që  të shfaqet në dritaren e ekranit **10**. Nëse jo, konfiguroni sërish një rrjet me valë (faqe 37).
- ➔ Kur sistemi lidhet me rrjet me valë, vendoseni LAN-in me valë/pikën e aksesit dhe sistemin më pranë njëri-tjetrit dhe kryeni sërish konfigurimin.
- ➔ Në varësi të ofruesve të shërbimit, lejohet vetëm një lidhje me internetin. Në këtë rast, sistemi nuk mund të lidhet nëse lidhja është e zënë. Ju lutemi konsultohuni me operatorin ose ofruesin e shërbimit.
- ➔ Kur ndizni telefonin tuaj celular (pajisjen Android, Xperia/Xperia Tablet ose iPhone/iPod touch/iPad) pas një momenti fikjeje, provoni të rindizni aplikacionin "Network Audio Remote".

## Rrjeti i shtëpisë

---

### Komanduesi nuk arrin ta gjejë këtë sistem. (Komanduesi nuk arrin të shfletojë përmbajtjen e këtij sistemi).

---

- ➔ Sigurohuni që kontrolluesi të jetë i lidhur me rrjetin e shtëpisë.
- ➔ Është aktivizuar kontrolli multikast në pikën e aksesit.

### Muzika fillon automatikisht.

---

- ➔ Ky sistem mund të kontrollohet nga një komponent tjetër. Për të refuzuar komandimin, vendoseni modalitetin BLUETOOTH/Network Standby (Gatishmëria e rrjetit) në fikur (faqe 62).

### Zëri është i ndërprerë.

---

- ➔ Serveri DLNA është i mbingarkuar. Mbyllni të gjitha aplikacionet e hapura.
- ➔ Gjendja e sinjalit me valë është e dobët. Hiqni nga puna furrën me mikrovalë.

---

## Riprodhimi nuk fillon.

---

- ➔ Konfirmoni që skedari audio është i pasaktë ose është fshirë nga serveri. Referojuni manualit të përdorimit të serverit.
- ➔ Serveri po provon ta luajë skedarin audio në një format audio që nuk mbështetet nga sistemi. Kontrolloni informacionin e formatit të audios në server.
- ➔ Çaktivizoni kontrolli multikast në ruterin LAN me valë/pikën e aksesit. Nëse aktivizohet, mund të duhen disa minuta që të dalë audioja. Për detaje, referojuni manualit të përdorimit të ruterit LAN me valë/pikës së aksesit.
- ➔ Aksesi nga ky sistem nuk lejohet nga serveri. Ndryshoni cilësimet në server për të lejuar aksesin nga ky sistem. Për detaje, referojuni manualit të përdorimit të serverit.

## AirPlay

---

## Sistemi nuk gjendet nga një pajisje iPhone/iPod Touch/iPad.

---

- ➔ Shikoni "Lidhja me rrjetin – Sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin" (faqe 73).
- ➔ Sigurohuni që pajisja iOS ose kompjuteri me iTunes të jetë lidhur me rrjetin e shtëpisë.
- ➔ Përditësoni iOS ose iTunes në versionin më të fundit përpara se ta përdorni me këtë sistem.

---

## Muzika fillon automatikisht.

---

- ➔ Ky sistem mund të kontrollohet nga një komponent tjetër. Për të refuzuar komandimin, vendoseni modalitetin BLUETOOTH/Network Standby (Gatishmëria e rrjetit) në fikur (faqe 62).

---

## Tingulli kapërcehet gjatë riprodhimit.

---

- ➔ Serveri është i mbingarkuar. Mbyllni të gjitha aplikacionet e hapura.

---

## Kjo njësi nuk mund të përdoret.

---

- ➔ Përditësoni versionin e softuerit të iPhone/iPod Touch/iPad në versionin e fundit.

## Për të rivendosur sistemin në cilësimet e fabrikës

Nëse sistemi vazhdon të mos funksionojë mirë, rivendosni sistemin në cilësimet e fabrikës.

Përdorni butonat në njësi për të rivendosur sistemin në cilësimet e fabrikës.

1 Shkëputni kordonin elektrik dhe konfirmoni që treguesi **STANDBY** [2] nuk është i ndezur. Më pas lidhni përsëri kordonin elektrik dhe ndizni sistemin.

2 Mbani shtypur **[7]** dhe **I/⏻** [1] në njësi derisa të shfaqet "ALL RESET" në ekran. Fshihen të gjitha cilësimet e konfiguruar nga përdoruesi, siç janë stacionet e paravendosura të radios, ora, kohëmatësi dhe rrjeti. Nëse problemi vazhdon pasi të kryeni të gjitha sa më sipër, këshillohuni me shitësin më të afërt të Sony.

# Mesazhet

Mesazhet e mëposhtme mund të shfaqen ose të pulsojnë gjatë funksionimit.

## **CANNOT DOWNLOAD**

Sistemi nuk arriti të shkarkonte të dhënat e përditësimit teksa kryente përditësimin e softuerit. Hyni në menunë e cilësimeve dhe përditësojeni sërish softuerin.

## **CANNOT PLAY**

Sistemi nuk mund të luajë skedarët audio për shkak të një formati skedari të pambështetur ose një kufizimi të luajtjes.

## **CAN'T PLAY**

Keni vendosur një disk që nuk mund të luhet në këtë sistem, si disk CD-ROM dhe DVD.

## **COMPLETE**

Funksioni i paravendosur i stacionit përfundoi normalisht.

## **DATA ERROR**

Keni provuar të luani një skedar që nuk mund të luhet.

## **ERROR**

Keni përdorur sistemin gjatë procesit të fillimit. Prisni pak deri sa të përfundojë procesi i fillimit.

## **INITIAL**

Sistemi po fillon cilësimet për rrjetin. Disa butona në sistem nuk mund të përdoren gjatë këtij procesi.

## **LOCKED**

Foleja e diskut [12] është e bllokuar dhe nuk mund ta hiqni diskun. Kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.

## **NO CONNECT**

Sistemi nuk mund të lidhet me rrjetin.

## **NO DEVICE**

Nuk është lidhur asnjë pajisje USB ose pajisja e lidhur USB është shkëputur.

## **NO DISC**

Nuk ka disk në luajtës, ose keni ngarkuar një disk që nuk mund të luhet.

## **NO MEMORY**

Mjeti i memories nuk është futur në pajisjen USB ose sistemi nuk e identifikon mjetin e memories.

## **NO STEP**

Janë fshirë të gjitha pjesët e programuara.

## **NO SUPPORT**

Sistemi nuk e mbështet pajisjen USB të lidhur.

## **NO TRACK**

Në pajisjen USB ose në disk nuk ka skedarë që mund të luhen.

## **NOT IN USE**

Keni shtypur një buton që nuk luhet.

## **OVER CURRENT**

Shkëputni pajisjen USB nga porta, fikni sistemin dhe më pas ndizni përsëri sistemin.

## **PUSH STOP**

Keni shtypur PLAY MODE [27] gjatë riprodhimit në funksionin CD ose USB.

## **READING**

Sistemi po lexon informacionet në disk ose në pajisjen USB. Disa butona nuk punojnë gjatë leximit.

## **STEP FULL**

Keni provuar të programoni më shumë se 25 pjesë ose skedarë.

**TIME NG**

Koha e fillimit dhe përfundimit të kohëmatësit me lajtje janë vendosur në të njëjtën kohë.

**UPDATE ERROR**

Sistemi nuk arrin të përditësojë softuerin. Fikni sistemin dhe më pas ndizeni sërish. Sistemi do të përpiqet të përditësojë softuerin. Nëse shfaqet i njëjti mesazh, kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.

# Masat paraprake

## Disqet që MUND të luhen në këtë sistem

- Disqet CD-DA audio
- CD-R/CD-RW (të dhëna audio të pjesëve të CD-DA dhe skedarë MP3)

Mos përdorni një disk CD-R/CD-RW pa të dhëna të ruajtura në të. Duke vepruar kështu mund të dëmtoni diskun.

## Disqet që NUK MUND të luhen në këtë sistem

- CD-ROM
- CD-R/CD-RW përveç atyre të regjistruara në format CD muzikore ose formate që janë në përputhje me ISO9660 Nivel 1/ Nivel 2, Joliet
- CD-R/CD-RW të regjistruara në format me shumë sesione dhe që nuk kanë mbyllur sesionin
- CD-R/CD-RW me cilësi të dobët regjistrimi, CD-R/CD-RW që kanë gërvishje ose janë të ndotura, ose CD-R/CD-RW të regjistruara me një pajisje regjistrimi të papajtueshme
- CD-R/CD-RW që nuk janë finalizuar saktë
- Disqet CD-R/CD-RW që përmbajnë skedarë përveç skedarëve MPEG 1 Audio Layer-3 (MP3)
- Disqet me forma jostandarde (p.sh. në formë zemre, katrore, ylli)
- Disqet që kanë shirit adeziv, letër ose material ngjitës përsipër
- Disqet me qira ose të përdorura me vula të ngjitura ku ngjitësja kalon përtej vulës
- Disqet që kanë etiketa të printuara me bojë që kur preket duket ngjitëse

## Shënime mbi disqet CD-DA

- Përpara luajtjes, fshini diskun me një pëlhurë pastrimi duke filluar nga qendra drejt anëve.
- Mos i pastroni disqet me tretës si benzina, holluesit ose pastruesit që qarkullojnë në treg, ose sprejtë antistatikë që përdoren për disqet LP prej vinili.

- Mos i ekspozoni disqet ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose burimeve të nxehtësisë siç janë tubacionet e ajrit të nxehtë, ose mos e lini në një makinë të parkuar në dritë të drejtpërdrejtë dielli.

## Për sigurinë

- Shkëputni plotësisht kordonin e rrymës (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rryma) nëse nuk do të përdoret për një periudhë të gjatë kohe. Kur hiqni sistemin nga priza, gjithmonë mbajeni me dorë prizën. Asnjëherë mos tërhiqni vetë kordonin.
- Nëse brenda në sistem bie diçka e fortë ose lëng, sistemi duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.
- Kordoni i rrymës alternative mund të zëvendësohet vetëm nga një dyqan servisi i kualifikuar.

## Për vendosjen

- Mos e vendosni sistemin në një pozicion të pjerrët ose në vende që janë shumë të nxehta, të ftohta, me pluhur, të ndotura ose me lagështirë ose ku mungon ajrosja e mjaftueshme apo ku mund t'u nënshtrohet dridhjeve, dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose dritës së fortë.
- Kini kujdes kur vendosni sistemin mbi dysheme me trajtim të veçantë (për shembull të trajtuara me dyllë, vaj, me lustër) duke qenë se mund të rezultojë në njolla ose çngjyrosje.
- Nëse sistemi silltet direkt nga një vend i ftohtë në një vend të ngrohtë, ose vendoset në një dhomë shumë të lagësht, lagështira mund të kondensohet mbi lentet brenda luajtësit të CD-ve dhe të bëjë që sistemi të keqfunksionojë. Në këtë situatë, hiqni diskun dhe lëreni sistemin të ndezur për rreth një orë derisa të avullojë lagështira.

### **Për akumulimin e nxehtësisë**

- Akumulimi i nxehtësisë në njësi gjatë funksionimit është normal dhe nuk është shkak për t'u alarmuar.
- Mos e prekni kasën e pajisjes nëse është përdorur në mënyrë të vazhdueshme me volum të lartë sepse kasa e pajisjes mund të jetë nxehur.
- Mos bllokoni vrimat e ajrimit.

### **Për sistemin e altoparlantëve**

Ky sistem altoparlantësh nuk është me mbrojtje magnetike dhe pamja në televizorët pranë mund të distortohej magnetikisht. Në këtë situatë, fikni televizorin, prisni 15 deri 30 minuta, dhe ndizeni sërish.

### **Pastrimi i kasës së pajisjes**

Pastrojeni këtë sistem me një pëlhurë të butë, disi të njomur me solucion të butë larës. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si holluesit, alkooli ose benzina.

# Teknologjia BLUETOOTH me valë

Teknologjia BLUETOOTH me valë është një teknologji me rreze të shkurtër për lidhjen e pajisjeve dixhitale, si kompjuterë personalë dhe kamera fotografike dixhitale. Me anë të teknologjisë BLUETOOTH me valë, ju mund të përdorni njësitë e përfshira brenda një rrezeje rreth 10 metra.

Teknologjia BLUETOOTH me valë zakonisht përdoret mes dy pajisjeve, por një pajisje e vetme mund të lidhet edhe me pajisje të shumta.

Nuk nevojiten lidhje kablore për t'u lidhur si me një lidhje USB dhe nuk nevojitet vendosja e pajisjeve ballë për ballë si me teknologjinë infra të kuqe me valë. Mund ta përdorni teknologjinë me një pajisje BLUETOOTH në çantë apo në xhep.

Teknologjia BLUETOOTH me valë është një standard global që mbështetet nga mijëra kompani. Këto kompani prodhojnë produkte që përputhen me standardin global.

## Versioni dhe profilet e mbështetura të BLUETOOTH

Profili i referohet një seti standard kapacitetesh për kapacitete të ndryshme të produkteve BLUETOOTH. Shikoni "Specifikimet" (faqe 81) për hollësi rreth versioneve të mbështetura të BLUETOOTH.

## Shënime

- Për të përdorur një pajisje BLUETOOTH të lidhur me këtë sistem, pajisja duhet të mbështesë të njëjtin profil si ky sistem. Kini parasysh se funksionet e pajisjes BLUETOOTH mund të jenë të ndryshme në varësi të specifikimeve të pajisjes, edhe nëse ka të njëjtin profil si ky sistem.
- Për shkak të vetive të teknologjisë BLUETOOTH me valë, luajtja në këtë sistem është pak e vonuar në krahasim me luajtjen audio në pajisjen transmetuese.

## Rrezja efikase e komunikimit

Pajisjet BLUETOOTH duhet të përdoren brenda afërsisht 10 metrave (distanca pa pengesa) nga njëra-tjetra.

Rrezja efikase e komunikimit mund të shkurtrohet në kushtet e mëposhtme.

- Kur mes pajisjeve me lidhje BLUETOOTH ndodhet një person, objekt metalik, mur apo pengesë tjetër
- Vendndodhjet ku është instaluar një LAN me valë
- Rreth furrave me mikrovalë që janë në përdorim
- Vendndodhjet ku ka valë të tjera elektromagnetike

## Efektet e pajisjeve të tjera

Pajisjet BLUETOOTH dhe rrjeti LAN me valë (IEEE802.11b/g) përdorin të njëjtin brez frekuece (2,4 GHz). Kur përdorni pajisjen tuaj BLUETOOTH pranë një pajisjeje me kapacitet për LAN me valë, mund të ndodhin interferenca elektromagnetike. Kjo mund të sjellë shpejtësi më të ulëta të transferimit të të dhënave, zhurmë ose pamundësi për t'u lidhur. Nëse ndodh kjo, provoni zgjidhjet e mëposhtme:

- Provoni ta lidhni këtë sistem dhe telefonin celular BLUETOOTH ose pajisjen BLUETOOTH kur jeni të paktën 10 metra larg nga pajisja LAN me valë
- Fikni rrymën e pajisjes LAN me valë kur përdorni pajisjen tuaj BLUETOOTH brenda 10 metrave

## Efektet në pajisjet e tjera

Valët radio të transmetuara nga ky sistem mund të interferojnë në funksionimin e pajisjeve mjekësore. Duke qenë se kjo interferencë mund të sjellë keqfunksionim, fikni gjithmonë rrymën e këtij sistemi, telefonin celular BLUETOOTH dhe pajisjen BLUETOOTH në vendet e mëposhtme:

- Nëpër spitale, trena dhe avionë
- Pranë deryeve automatike ose alarmeve të zjarrit

## Shënime

- Ky sistem mbështet funksionet e sigurisë që përputhen me specifikimin BLUETOOTH si një mënyrë për të garantuar sigurinë gjatë komunikimit me teknologjinë BLUETOOTH. Megjithatë, kjo siguri mund të jetë e pamjaftueshme në varësi të përmbajtjes së cilësimit dhe faktorëve të tjerë, prandaj gjithmonë kini kujdes kur kryeni komunikimin duke përdorur teknologjinë BLUETOOTH.
- Sony nuk është përgjegjës për asnjë mënyrë dëmtimi apo humbje tjetër si rezultat i rrjedhjes së informacionit gjatë komunikimit duke përdorur teknologjinë BLUETOOTH.
- Komunikimi BLUETOOTH nuk është domosdoshmërisht i garantuar me të gjitha pajisjet BLUETOOTH që kanë të njëjtin profil si ky sistem.
- Pajisjet BLUETOOTH të lidhura me këtë sistem duhet të përputhen me specifikimin BLUETOOTH të përshkruar nga BLUETOOTH SIG, Inc. dhe duhet të jenë të certifikuara si të përputhshme. Megjithatë, edhe kur një pajisje përputhet me specifikimin BLUETOOTH, mund të ketë raste kur karakteristikat apo specifikimet e pajisjes BLUETOOTH mund ta bëjnë të pamundur lidhjen, ose mund të rezultojnë në metoda të ndryshme kontrolli, paraqitjeje apo funksionimi.
- Mund të shkaktohet zhurmë ose audioja mund të ndërpritet në varësi të pajisjes BLUETOOTH që është lidhur me këtë sistem, mjedisin e komunikimeve apo kushtet rrethuese.



# Specifikimet

---

## Seksioni i amplifikatorit

### Dalja e fuqisë (nominale):

25 vat + 25 vat (në 6 om, 1 kHz, 1% THD)

### Dalja e fuqisë RMS (e referuar):

50 vat + 50 vat (për kanal në 6 om, 1 kHz)

---

## Hyrjet/daljet

### AUDIO IN:

Foleja AUDIO IN (hyrja e jashtme):  
Fole stereo mini, ndjeshmëria 700 mV,  
rezistenca 47 kilo-om

Foleja [11] (kufje):

Foleja mini stereo, 8 om ose më shumë

### USB:

#### Shpejtësia në bit e mbështetur:

MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3):

32 kbps - 320 kbps, VBR

WMA: 48 kbps - 192 kbps, VBR

AAC: 48 kbps - 320 kbps

#### Frekuencat shembull:

MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3): 32/44,1/48 kHz

WMA: 44,1 kHz

AAC: 44,1 kHz

#### Porta USB:

Lloji A, 5 V DC 2,1 A

---

## Seksioni i luajtësit të CD-DA/MP3

### Sistemi:

Sistem kompakt disk dhe audio dixhitale

### Vetitë e lazerit diodit:

Kohëzgjatja e emetimit: E vazhdueshme  
Dalja lazer\*: Më pak se 44,6  $\mu$ W

\* Kjo dalje është masa e vlerës në një distancë prej 200 mm nga sipërfaqja e lentes së objektivit në bllokun marrës optik me hapje 7 mm.

### Reagimi i frekuencës:

50 Hz - 20 kHz

### Raporti sinjal-zhurmë:

Më shumë se 90 dB

### Variacioni dinamik:

Më shumë se 90 dB

---

## Seksioni i sintonizuesit

### Seksioni i sintonizuesit AM

#### (vetëm CMT-SBT300W):

Diapazoni i sintonizimit:

#### Modelet evropiane:

531 kHz - 1602 kHz (me intervalin e sintonizimit 9 kHz)

#### Modelet e tjera:

530 kHz - 1710 kHz (me intervalin e sintonizimit 10 kHz)

531 kHz - 1710 kHz (me intervalin e sintonizimit 9 kHz)

#### Antena:

Antenë AM në formë kornize

#### Frekuenca e ndërmjetme:

400 kHz

### Seksioni i sintonizuesit FM:

FM stereo, sintonizues FM superheterodin

#### Diapazoni i sintonizimit:

87,5 MHz - 108,0 MHz (hapa me nga 50 kHz)

#### Antena:

Antenë përcjellëse FM

### Seksioni i sintonizuesit DAB/DAB+

#### (vetëm CMT-SBT300WB):

FM stereo, sintonizues DAB/FM superheterodin

#### Gama e frekuencës:

Brezi-III:

174,928 (5A) MHz - 239,200 (13F) MHz\*

#### Antena:

Antenë përcjellëse DAB/FM:

## Tabela e frekuencave DAB/DAB+ (Brezi-III):

Frekuenca	Etiketa
174,928 MHz	5A
176,640 MHz	5B
178,352 MHz	5C
180,064 MHz	5D
181,936 MHz	6A
183,648 MHz	6B
185,360 MHz	6C
187,072 MHz	6D
188,928 MHz	7A
190,640 MHz	7B
192,352 MHz	7C
194,064 MHz	7D
195,936 MHz	8A
197,648 MHz	8B
199,360 MHz	8C
201,072 MHz	8D
202,928 MHz	9A
204,640 MHz	9B
206,352 MHz	9C
208,064 MHz	9D
209,936 MHz	10A
211,648 MHz	10B
213,360 MHz	10C
215,072 MHz	10D
216,928 MHz	11A
218,640 MHz	11B
220,352 MHz	11C
222,064 MHz	11D
223,936 MHz	12A
225,648 MHz	12B
227,360 MHz	12C
229,072 MHz	12D
230,784 MHz	13A
232,496 MHz	13B
234,208 MHz	13C
235,776 MHz	13D
237,488 MHz	13E
239,200 MHz	13F

\* Frekuencat paraqiten me dy shifra dhjetore në këtë sistem.

## Seksioni i altoparlantëve

### Sistemi i altoparlantëve:

Sistem altoparlantësh me 2 drejtime,  
Refleks Bas  
Altoparlanti bas: 120 mm, e llojit konik  
Altoparlanti për frekuenca të larta: 25 mm,  
i llojit të rumbullakët

### Rezistenca nominale:

6 om

### Përmasat (GJ/L/TH):

Afërsisht 150 mm x 270 mm x 220 mm

### Masa:

Afërsisht 2,5 kg (për njësi)

## Seksioni BLUETOOTH

### Sistemi i komunikimit:

BLUETOOTH Standard versioni 3.0

### Dalja:

BLUETOOTH Standard Kategoria e fuqisë 2

### Rrezja maksimale e komunikimit:

Rrezja e shikimit rreth 10 m<sup>\*1</sup>

### Brezi i frekuencës:

Brezi 2,4 GHz (2,4000 GHz – 2,4835 GHz)

### Metoda e modulimit:

FHSS

### Profilët e përputhshme BLUETOOTH\*2:

A2DP (Profili i përparuar i shpërndarjes audio)

AVRCP (Profili i telekomandimit audio video)

### Metoda e mbështetur e mbrojtjes së përmbajtjes

Metoda SCMS-T

### Gjerësia e brezit të transmetimit

20 Hz – 20 000 Hz (me shembull 44,1 kHz)

\*1 Rrezja aktuale varion në varësi të faktorëve si pengesat mes pajisjeve, fushat magnetike rreth një furre me mikrovalë, elektriciteti statik, ndjeshmëria e marrjes, performanca e antenës, sistemi operativ, aplikacioni i softuerit, etj.

\*2 Profilët standardë BLUETOOTH tregojnë qëllimin e komunikimit BLUETOOTH mes pajisjeve.

---

## Seksioni i rrjetit

### Porta LAN:

RJ-45

10BASE-T/100BASE-TX

(Shpejtësia e komunikimit mund të variojë në varësi të mjedisit të komunikimit. Sistemi nuk garanton shpejtësinë e komunikimit dhe cilësinë e 10BASE-T/100BASE-TX.)

### Rrjeti LAN me valë:

Standardet e përputhshme:

IEEE 802.11 b/g (WEP 64 bit, WEP 128 bit)

Brezi i frekuencës 2,4 GHz

(2,4000 GHz – 2,4835 GHz)

Kanalet e disponueshme ch1 deri ch13

WPA/WPA2-PSK (AES)

WPA/WPA2-PSK (TKIP)

---

## Të përgjithshme

### Furnizimi me energji:

AC 220 V – 240 V, 50 Hz/60 Hz

### Konsumi i energjisë:

36 vat

### Përmasat (GJ/L/TH) (përfshirë pjesët projektuese, pa altoparlantët):

Afërsisht 290 mm × 106 mm × 221 mm

### Masa (pa altoparlantët):

Afërsisht 2,5 kg

### Aksesorët shoqërues:

Telekomanda (RM-AMU171) (1), R6 (Madhësia AA) bateritë (2), kordoni i altoparlantit (2), gomina altoparlantësh (8), antenë FM përcjellëse/AM në formë kornize (1) (vetëm CMT-SBT300W), antenë përcjellëse DAB/FM (1) (vetëm CMT-SBT300WB), Udhëzuesi i shpejtë i konfigurimit (1), Udhëzimet e përdorimit (ky manual) (1)

Dizajni dhe specifikimet i nënshtrohen ndryshimit pa dhënë njoftim.

Konsumi i energjisë në gatishmëri: 0,5 W
--

## Markat tregtare, etj.

- Windows, logoja Windows dhe Windows Media janë marka tregtare të regjistruara ose marka tregtare të Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose në shtete të tjera.
- Ky produkt është i mbrojtur nga disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft Corporation. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencë nga Microsoft ose një filial i autorizuar i Microsoft.
- AirPlay, logoja AirPlay, iPad, iPhone, iPod, iPod classic, iPod nano dhe iPod touch janë marka tregtare të Apple Inc., të regjistruara në SHBA dhe vendet e tjera.
-  është markë e Wi-Fi Alliance.
- Wi-Fi®, Wi-Fi Protected Access® dhe Wi-Fi Alliance® janë marka të regjistruara të Wi-Fi Alliance.
- Wi-Fi CERTIFIED™, WPA™, WPA2™ dhe Wi-Fi Protected Setup™ janë marka të Wi-Fi Alliance.
- DLNA™, logoja DLNA dhe DLNA CERTIFIED™ janë marka tregtare, marka shërbimi ose marka certifikimi të Digital Living Network Alliance.
- Teknologjia e audiokodimit MPEG Layer-3 dhe patentat të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- Shenja e fjalës dhe logot BLUETOOTH® janë marka tregtare të regjistruara që zotërohen nga BLUETOOTH SIG, Inc. SIG, Inc. dhe çdo përdorim i tyre nga Sony Corporation bëhet me licencë. Të gjitha markat e tjera tregtare dhe emrat tregtarë janë të zotëruesve të tyre përkatës.
- N Mark është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera.
- Android është markë tregtare e Google Inc.
- "Xperia" dhe "Xperia Tablet" janë marka tregtare të Sony Mobile Communications AB.
- Emrat e sistemeve dhe produkteve të treguara në këtë manual janë në përgjithësi marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të prodhuesit. Shenjat ™ dhe ® janë hequr në këtë manual.



<http://www.sony.net/>

